

Kodi i Shpërndarjes

Versioni 1.0

Korrik 2008

Prishtinë

PËRMBAJTJA

Kapitulli I	5
1 Parathënie	5
1.1 Struktura e Sistemit Elektroenergjetik (SEE).....	5
1.2 Përdorimi i Sistemit të Shpërndarjes	6
1.3 Kodi i Shpërndarjes dhe Dokumentimet tjera	6
1.4 Struktura e Kodit të Shpërndarjes.....	8
Kapitulli II	9
2 Kushtet e Përgjithshme të Shpërndarjes	9
2.1 Hyrje.....	9
2.2 Objektivi	9
2.3 Qëllimi.....	9
2.4 Asistenca në Implementim	9
2.5 Rrethanat e Paparashikueshme.....	10
2.6 Hierarkia	10
2.7 Rishikimi i Kodit të Shpërndarjes	11
2.8 Komunikimet në mes OSSh-së dhe Përdoruesve	11
2.9 Situatat Emergjente.....	11
2.10 Përgjegjësitë e Kodit.....	11
2.11 Derogimet	12
2.12 Mosmarrëveshjet	14
2.13 Administratori i Kodit.....	14
Kapitulli III	15
3 Përcaktimi i Termave dhe Definicionet	15
Kapitulli IV	22
4 Planifikimi i Sistemit të Shpërndarjes	22
4.1 Hyrje.....	22
4.2 Objektivat	22
4.3 Qëllimi.....	23
4.4 Kriteret e Planifikimit	24
4.5 Kriteret për Verifikimin e Dimensionimit të Sistemit të Shpërndarjes	25
4.6 Standardet e Dizajnit.....	25
4.6.1 Frekuenca	25
4.6.2 Tensioni	25
4.6.3 Kërkesat për Gjeneruesit e Pavarur të Energjisë të Lidhur Direkt në Sistemin e Shpërndarjes	27
4.6.4 Të dhënat që kërkohen nga të gjithë Konsumatorët, përfshirë dhe Konsumatorët e Privilegjuar të lidhur në Sistemin e Shpërndarjes	27
4.6.5 Kriteret për Tokëzim	28
4.7 Transferimi i të Dhënave Planifikuese	29
4.7.1 Informatat e Planifikuara duhet të sigurohen nga Përdoruesit.....	29
4.7.2 Informatat që duhet Shkëmbyer	30
4.7.3 Analizat e Planifikimit.....	31
Kapitulli V	33
5 Kushtet Teknike të Kycjes në Sistemin e Shpërndarjes.....	33
5.1 Hyrje.....	33
5.2 Objektivi	33
5.3 Qëllimi.....	34
5.4 Informata e Kërkuar për Kycje	34
5.5 Aranzhimet e Kycjes.....	38
5.5.1 Tensioni i Kycjes	38

5.5.2	Informata e dhënë nga OSSh	39
5.5.3	Kufijtë e Pronësisë	40
5.6	Kriteret Teknike për Kyçe	41
5.6.1	Standardet e kyçjes	41
5.6.2	Kërkesat e Mbrojtjes.....	42
5.6.3	Tokëzimi.....	45
5.6.4	Rregullimi i Tensionit dhe Kontrollimi.....	45
5.6.5	Nivelet e Lidhjeve të shkurtra	45
5.6.6	Nivelet e Izolimit.....	46
5.6.7	Ndikimet Kapacitive dhe Induktive	47
5.6.8	Ç'rregullimet e Tensionit.....	47
5.6.9	Faktori i Fuqisë dhe Ekuilibrimi i Fazës	50
5.7	Matja /Telematja	50
5.8	Aranzhimet Specifike.....	51
Kapitulli VI	53
6	Operimi i Sistemit të Shpërndarjes	53
6.1	Pjesa e përgjithshme.....	53
6.1.1	Hyrje.....	53
6.1.2	Rrjedhja e Informatave dhe Ko-ordinimi.....	54
6.1.3	Të Dhënat mbi Parashikimin e Kërkesës	54
6.1.4	Humbja e Qendrës së Kontrollit.....	55
6.2	Koordinimi i ndërprerjeve të planifikuara	55
6.2.1	Qëllimi dhe Objektivat e Koordinimit të Ndërprerjeve të Planifikuara.....	55
6.2.2	Përgatitja e Informatave	57
6.2.3	Orari Kohor dhe të Dhënat.....	57
6.2.4	Informata mbi Gjeneratorët e pavarur.....	57
6.2.5	Informatat për Përdoruesit	58
6.3	Menaxhimi i ngarkesave për raste të veçanta	58
6.3.1	Qëllimi i Menaxhimit të Ngarkesave për Rastet e Veçanta.....	58
6.3.2	Metodat e Kontrollimit të Ngarkesës.....	59
6.3.3	Implementimi i Kontrollimit të Ngarkesës.....	60
6.4	Komunikimi Operues dhe Veprimi.....	61
6.4.1	Qëllimi dhe Objektivat e Komunikimit Operues	61
6.4.2	Procedurat për komunikim operues dhe veprim	61
6.4.3	Incidentet e Rënda	63
6.5	Raportimi i Rasteve.....	63
6.5.1	Qëllimi i Raportimit të Rasteve	63
6.5.2	Procedurat për Raportimin e Rasteve	64
6.5.3	Hulumtimet e Përbashkëta.....	65
6.5.4	Raporti i Shkruar mbi Incidentin e Rëndë.....	65
6.6	Testimi i Sistemit	66
6.6.1	Qëllimi dhe Objektivat e Testimit të Sistemit	66
6.6.2	Procedurat e Testimit të Sistemit	67
6.7	Monitorimi, Testimi dhe Hulumtimi.....	69
6.7.1	Qëllimi i Monitorimit, Testimit dhe Hulumtimit.....	69
6.7.2	Procedurat e Monitorimit, Testimit dhe Hulumtimit	70
6.8	Normat e Sigurisë Industriale.....	71
6.8.1	Qëllimi dhe Objektivat e Sigurisë Industriale.....	71
6.8.2	Procedurat e Sigurisë Industriale.....	71
6.8.3	Siguria në vendin e kyçjes/Pika e Kyçjes së Përdoruesit.....	72
6.8.4	Rregullat e Sigurisë Industriale	73

6.9	Siguria e Furnizimit.....	74
Kapitulli VII		76
7.	Regjistri i të Dhënave Teknike	76
7.1	Hyrje.....	76
7.2	Fushë veprimi	76
7.3	Procedurat dhe Përgjegjësitë.....	76
7.4	Të Dhënat që duhet të Regjistrohen	77
7.5	Planifikimi (lista) i (e) të Dhënave.....	78

Kapitulli I

1 Parathënie

1.1 Struktura e Sistemit Elektroenergjetik (SEE)

1.1.1 **Operator i Sistemit të Transmisionit (OST)** operon **Sistemin e Transmisionit**. **Sistemi i Transmisionit** transmeton energjinë elektrike, të gjeneruar nga **Njësitë e Gjenerimit** dhe interkonekcionit, deri tek **konsumatorët** direkt dhe **Sistemi i Shpërndarjes**, nëpërmes të cilit furnizohen **konsumatorët fundor**.

1.1.2 Pronari i asetëve të **Sistemit të Transmisionit** është **Operatori i Sistemit të Transmisionit (OST)**.

1.1.3 **Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSh)** është përgjegjës për operimin dhe mirëmbajtjen e sigurt, të qëndrueshëm dhe eficient të **Sistemit të Shpërndarjes**. **Sistemi i Shpërndarjes** bart energjinë elektrike nga **Sistemi i Transmisionit** ose nga **Njësitë Gjeneruese** të pavarura deri tek **konsumatori fundor**.

1.1.4 **Furnizuesi publik/furnizuesit e pavarur** furnizojnë me energji elektrike **Konsumatorët**. Për këtë qëllim, **Furnizuesit** do të kenë mundësi që të përdorin **Sistemin e Transmisionit** dhe **Sistemin e Shpërndarjes** për bartjen e energjisë elektrike nga **Njësitë e Gjenerimit** deri tek **Konsumatorët**.

1.1.5 **Gjeneratorët** gjenerojnë energji elektrike e cila dërgohet në **Sistemin e Transmisionit** ose të **Shpërndarjes** varësisht nga lloji i tyre. **Njësitë e Gjenerimit** klasifikohen sipas tensionit të tyre, fuqisë dalëse, vendit të kyçjes si dhe në bazë të asaj se a janë apo nuk janë të nënshtruara rregullave të **Qendrës Nacionale Dispeçerike OST**.

1.1.6 **Konsumatorët** blejnë energjinë elektrike nga **Furnizuesi publik** dhe **Furnizuesit e pavarur**. Disa **Konsumatorët** kanë njësitë e tyre për **gjenerim**, për furnizim të plotë ose të pjesërishtë të nevojave të tyre. Këta **konsumatorë** referohen si **Konsumatorë Vet-Prodhuës KVP**.

1.2 Përdorimi i Sistemit të Shpërndarjes


1.2.1 Përdorimi i **Sistemit të Shpërndarjes** mund të përfshijë çdo njërin nga këto veprime si në vijim:

- (a) Lidhja në hyrje ose në dalje të **Sistemit të Shpërndarjes**. Pika hyrëse është lidhja në mes të **Sistemit të Shpërndarjes** dhe **Sistemit të Transmisionit** ose të **Njësive Gjeneruese**. Pika dalje është lidhja në mes të **Sistemit të Shpërndarjes** dhe të vendit të kyçjes të **konsumatorit**.
- (b) Përdorimi i **Sistemit të Shpërndarjes** për bartjen e energjisë elektrike në mes pikave hyrëse dhe dalje.
- (c) Konstruksionin e **Pikës Lidhëse**.
- (d) Puna ose operimi që ka të bëjë me pajisjet në pikat e ndërlidhjes me **Sistemin e Shpërndarjes**.

1.3 Kodi i Shpërndarjes dhe Dokumentimet tjera

1.3.1 **Kodi i Shpërndarjes** është përgatitur nga **OSSH – OST**, në përputhje me Nenin 38.7 të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe akteve tjera nënligjore mbi energjinë elektrike. Definon të gjitha aspektet teknike të mardhënjes së punës në mes të **OSSH-së** dhe të gjithë **përdoruesve** të **Sistemit të Shpërndarjes**, që të siguroj një efikasitet, ko-ordinim dhe një sistem ekonomik për shpërndarje të energjisë elektrike. Gjithashtu ky Kod i mundëson **OSSH-së** që të jetë në pajtushmëri me përgjegjësitë që dalin nga **Licenca e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes** dhe me **Kodin e Rrjetit** dhe të **Matjes**.

1.3.2 Raportet në mes të **Kodit të Rrjetit** dhe **Kodit të Shpërndarjes** janë paraqitur si në figurën më poshtë.



1.3.3 **Përdoruesit** e kyçur në **Sistemin Shpërndarjes** duhet të jenë në përputhje me dispozitat përkatëse të **Kodit të Shpërndarjes**. Përdoruesve gjithashtu duhet t'u kërkohej që të hyjnë në **marrëveshje të kyçjes** dhe **marrëveshje tjera**. Nga **konsumatorët** dhe **gjeneratorët** e pavarur të kyçur në **Sistemin e Shpërndarjes** do të kërkohej të kenë **marrëveshje** me **OSSh**-në për **kyçje** në **sistemin shpërndarës**, gjithashtu **Furnizuesve** do t'u kërkohej të hyjnë në **marrëveshje** me **OSSh**-në për përdorimin e **Sistemit të Shpërndarjes**.

1.3.4 **Përdoruesit** obligohen të jenë në përputhje me kriteret e këtyre dokumenteve ashtu siç është e përshtatshme për rrethanat e tyre.

1.4 Struktura e Kodit të Shpërndarjes

1.4.1 Kodi i Shpërndarjes është i ndarë në kapitujt si në vazhdim:

- **Kapitulli 1 - Parathënie**
- **Kapitulli 2 - Kushtet e Përgjithshme të Shpërndarjes (KPSH)** përcaktojnë kornizën ligjore të udhëheqjes së punës me **Kodin e Shpërndarjes**.
- **Kapitulli 3 – Përcaktimi i Termave dhe Definicionet**
- **Kapitulli 4 – Planifikimi i Sistemit të Shpërndarjes (PSSh)** përmban detaje të standardit të furnizimit të ofruar gjithashtu edhe parimet e dizajnit sipas të cilave është ndërtuar **Sistemi i Shpërndarjes**. PSSh ju mundëson **përdoruesve** të marrin informata të caktuara nga **OSSH** për **Sistemin e Shpërndarjes** në rrethana të caktuara.
- **Kapitulli 5 – Kushtet e kyçjes në Sistemin e Shpërndarjes (KKSSH)** ofrojnë detaje të kërkesave teknike dhe të tjera që duhet të përmbushen prej atyre që kërkojnë **kyçjen** në **Sistemin e Shpërndarjes**. Kushtet specifike të cilat i takojnë **gjeneratorëve** të pavarur të kyçur në **Sistemin e Shpërndarjes** janë përfshirë në 4.6.3.
- **Kapitulli 6 – Operimi i Sistemit të Shpërndarjes (OSSh)** trajton çështje të ndryshme operative të cilat kanë ndikim tek **përdoruesi**, si ofrimi i parashikimit të ngarkesës, planifikimi i ndërprerjeve të **Sistemit të Shpërndarjes**, ndërprerjet e prodhimit, ndërprerjet e **Sistemit të Transmisionit**, raportimi i ndryshimit të operimeve dhe ngjarjeve, çështjet e sigurisë dhe procedurat për ballafaqimin me situata emergjente.
- **Kapitulli 7 – Regjistri i të Dhënave Teknike (RDhT)** përmbledhë në formë tabelare të dhënat e kërkesës nën **Kodin e Shpërndarjes**.

Kapitulli II

2 Kushtet e Përgjithshme të Shpërndarjes

2.1 Hyrje

2.1.1 Derisa secili kapitull në **Kodin e Shpërndarjes** përmban rregulla dhe dispozita në lidhje me Kushtet e Përgjithshme të **Shpërndarjes**, ekzistojnë dispozita të cilat janë më shumë për aplikim të përgjithshëm. Këto janë të mbuluara në Kushtet e Përgjithshme të Shpërndarjes.

2.2 Objektivi

2.2.1 Kushtet e Përgjithshme të **Shpërndarjes** përmbajnë dispozita të cilat janë për aplikim të përgjithshëm tek të gjitha dispozitat e **Kodit të Shpërndarjes**. Objektivi i tyre është të sigurojnë, deri në masë të mundshme, aplikimin e qëndrueshëm të paragrafeve të ndryshme të **Kodit të Shpërndarjes** tek të gjithë konsumatorët e energjisë elektrike.

2.3 Fushëveprimi

2.3.1 Kushtet e Përgjithshme të **Shpërndarjes** aplikohen te të gjithë **Përdoruesit**.

2.4 Asistenca në Implementim

2.4.1 **Licenca e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes** detyron **OSSH** të zbatojë dhe obligojë **Kodin e Shpërndarjes**. Që të arrihet kjo, **OSSH** do të duhej qasje nëpër kufijtë e takimit (kufijtë e pronësisë), shërbime dhe pajisje të **përdoruesve** apo t'u lëshojë udhëzime **përdoruesve**, për shembull për të **izoluar** apo ç'kyçur stabilimentin apo pajisjet. Konsiderohet se këto raste do të jenë të veçanta dhe për këtë arsye nuk është e mundur të parashikohet me saktësi apo në mënyrë gjithëpërfshirëse se çka **OSSH** në mënyrë të arsyeshme do të kërkojë, ashtu që të vazhdojë me kryerjen e detyrave të veta në implementimin dhe zbatimin e **Kodit të Shpërndarjes**.

2.4.2 Të gjithë **Përdoruesve** u kërkohet të jenë në pajtim me **Kodin e Shpërndarjes** dhe gjithashtu të sigurojnë të drejtën në qasje, shërbime, pajisje për **OSSH** dhe të jenë në

përputhje me udhëzimet që në mënyrë të arsyeshme mund të kërkohen për të implementuar dhe zbatuar **Kodin e Shpërndarjes**.

2.5 Rrethanat e Paparashikueshme

2.5.1 Nëse shfaqen rrethana të cilat nuk janë të parashikuara në dispozitat e **Kodit të Shpërndarjes**, atëherë **OSSH** deri në masën e mundshme të arsyeshme praktike për rrethanat, menjëherë dhe me mirëbesim do të konsultojë **Përdoruesit** e ndikuar nga rrethanat e paraqitura duke u përpjekur për të arritur marrëveshje për atë se çfarë duhet bërë. Nëse marrëveshja nuk mund të arrihet brenda kohës në disponim, **OSSH** do të përcaktojë se çfarë duhet vepruar.

2.5.2 Kurdo që **OSSH** merr një vendim, do të ketë respekt për çdo situatë me pikëpamjet e shfaqura nga **Përdoruesit** deri në atë masë që është e arsyeshme për të gjitha rrethanat. **OSSH** do ta njoftojë **ZRrE**-në dhe **MEM**-in për veprimet e ndërmarra.

2.5.3 Çdo **Përdorues** duhet të veprojë në përputhje me të gjitha udhëzimet që i janë dhënë nga **OSSH** duke zbatuar një vendim të tillë në mënyrë që udhëzimet të jenë në përputhje me parametrat teknik të dhënë të një sistemi të veçantë të **Përdoruesit** të regjistruar në **Kodin e Shpërndarjes**. **OSSH** me përpikëri do t'i përcjell të gjitha rrethanat e paparashikueshme dhe ndonjë vendim të këtillë tek **KQKO** sipas Nenit 2.7 të këtij Kodi.

2.6 Hierarkia

2.6.1 Në rastin e ndonjë konflikti në mes të dispozitave të ndonjë rregulloreje të **KQKO** në njërën anë dhe dispozitave të **Kodit të Shpërndarjes** në anën tjetër, do të mbizotërojnë dispozitat e një udhëzimi të tillë të **KQKO**.

2.6.2 Në rastin e ndonjë konflikti në mes kushteve të **Kodit të Shpërndarjes** dhe të ndonjë kontrate, marrëveshje apo aranzhimi në mes **OSSH**-së dhe **Përdoruesit**, dispozitat e **Kodit të Shpërndarjes** do të mbizotërojnë përveç nëse **Kodi i Shpërndarjes** në mënyrë të qartë e parasheh ndryshe.

2.7 Rishikimi i Kodit të Shpërndarjes

2.7.1 **Kodi i Shpërndarjes** përcakton kushtet të cilat duhet të hartohen nga të gjitha **palët**. Rishikimi i Kodit të Shpërndarjes do të ndërmerret **nga Komisioni Qeverisës i Kodeve Operacionale (KQKO)** sipas “Rregullit mbi Procedurat e Qeverisjes për Kodet Teknike/Operacionale” të miratuara nga **Rregullatori. OSSh** do të marrë përgjegjësinë për inkorporimin e amendamenteve (ndryshimeve) të dakorduara nga **KQKO** dhe të aprovuara nga **Rregullatori** si dhe për nxjerrjen në qarkullim të kodit të amenduar (ndryshuar).

2.7.2 **OSSH** duhet të dorëzojë amendamentet e propozuara për **Kodin e Shpërndarjes te KQKO** për diskutim, pa marrë parasysh se cila palë propozon amendamente të tilla.

2.7.3 **OSSH** duhet që kohë pas kohe apo me urdhër të Komisionit të krijuar nga **KQKO**, duke marr parasysh rekomandimet e saj, të dorëzojë kodin e përmirësuar për aprovim në **ZRrE**.

2.8 Komunikimet në mes OSSh dhe Përdoruesve

2.8.1 Me përjashtim të rasteve kur është specifikuar ndryshe me **Kodin e Shpërndarjes**, metodat e komunikimit të punës dhe transferimi i të dhënave duhet të rregullohet kohë pas kohe me marrëveshje në mes të **OSSH-së** dhe **Përdoruesve**.

2.9 Situatat Emergjente

2.9.1 **Përdoruesit** duhet të njoftohen se dispozitat e **Kodit të Shpërndarjes** mund të pezullohen, në tërësi apo pjesërisht, në përputhje me udhëzimet e dhëna dhe/apo urdhëresat e bëra nga Ministria e Energjisë dhe Minierave të Republikës së Kosovës në përputhje me Ligjet primare për Energjinë.

2.10 Përgjegjësitë e Kodit

2.10.1 **Kodi i Shpërndarjes** përcakton procedurat dhe principet që rregullojnë marrëdhëniet mes **OSSH-së** dhe të gjithë **Përdoruesve** të **Sistemit të Shpërndarjes**.

2.11 Derogimet

2.11.1 Nëse ndonjë **Përdorues** mendon se nuk është, dhe nuk do të jetë në gjendje për t'iu përmbajtur dispozitave të **Kodit të Shpërndarjes** atëherë pa vonesë ajo mos përmbajtje duhet të raportohet tek **OSSH**, dhe në bazë të dispozitave 2.11.2 duhet të bëhen përpjekje të arsyeshme siç kërkohet për të evituar atë mospërputhje në mënyrën sa më shpejtë praktike të mundshme.

2.11.2 Rastet kur mospërputhja është:

a) në lidhje me stabilimentin dhe pajisjet e lidhura në **Sistemin e Shpërndarjes** kur shkaktohet vetëm apo kryesisht si rezultat i një rishikimi të **Kodit të Shpërndarjes**; apo

b) në lidhje me Stabilimentin dhe (apo) pajisjet që janë të kyçura, ku kyçja është e aprovuar, ose për një gjë të tillë kërkohet aprovimi për **kyçje** në **Sistemin e Shpërndarjes** dhe **Përdoruesi** mendon se cilido nga këto do të jetë e paarsyeshme (përfshirë koston dhe konsiderimet teknike) për të kërkuar përmirësimin e një mospërputhjeje të tillë ose në rastet kur duhet lejuar vazhdimin e afatit kohor për përmirësim e një mos-përputhjeje të dhënë në **Kodin e Shpërndarjes**. Në atë rast duhet që menjëherë të dorëzojë te **ZRrE** kërkesën për derogim të një dispozite të tillë në përputhje me kriteret në Nenin 2.11.3 dhe poashtu t'i sigurojë **OSSH**-në një kopje për një aplikim të tillë.

2.11.3 Kërkesa për derogim prej ndonjë dispozite të **Kodit të Shpërndarjes** duhet të përmbajë:

a) numrin e nenit (dispozitës) të lëshimit të **Kodit të Shpërndarjes**, kundrejt së cilit është identifikuar apo parashikuar mospërputhja e dispozitës;

b) identifikimi i stabilimentit dhe (ose) pajisjeve në lidhje me të cilat është kërkuar derogimi, nëse janë relevante, natyra dhe shtrirja në të cilën ekziston mospërputhja;

c) identifikimi i dispozitës me të cilin **Përdoruesi** nuk është, apo nuk do të jetë, në gjendje të jetë në përputhshmëri;

d) arsyeja për mospërputhje; dhe

e) data në të cilën do të arrihet përputhshmëria (nëse përmirësimet e mospërputhjes janë të mundshme) duke iu nënshtruar 2.11.2b).

2.11.4 Nëse **OSSH** konstaton se nuk është, apo nuk do të jetë, në gjendje të veprojë në përputhje me ndonjë dispozitë të **Kodit të Shpërndarjes**, atëherë duhet që në bazë të dispozitave në 2.11 të bëjë përpjekje të arsyeshme (ashtu siç kërkohet) për të përmirësuar një mospërputhje të tillë sipas dinamikës të cilën **OSSH** e prezanton.

2.11.5 Në rast se **OSSH** kërkon një derogim, atëherë **OSSH** duhet të paraqesë te **ZRrE** informacionin e paraqitur në 2.11.3.

2.11.6 Me pranimin e ndonjë kërkesë për derogim, **ZRrE** duhet menjëherë të marrë në konsiderim një kërkesë të tillë me kusht që të konsiderojë se bazat për derogim janë të arsyeshme. **ZRrE** do të lejoj një derogim të tillë përveç nëse derogimi do të ketë apo pritet që të ketë ndikim të pafavorshëm material apo në sigurinë dhe stabilitetin e **Sistemit të Shpërndarjes** apo do të imponojë kosto të paarsyeshme në operimin e **Sistemit të Shpërndarjes**, në **Sistemin e Transmisionit** apo në **Përdorues** tjerë. Në konsiderimin të kërkesës së **Përdoruesit** për derogim, **ZRrE** mund të kontaktojë **Përdoruesin** relevant dhe (ose) **OSSH**-në për të siguruar sqarimin e kërkesës dhe për t'i diskutuar ndryshimet në kërkesë. Nëse derogimi ka ndonjë ndikim në **Sistemin e Transmisionit**, **OSSH** duhet paraprakisht të veprojë së bashku me **OST** para se të sigurojë një vlerësim të **ZRrE**.

2.11.7 Deri në ç'masë ndonjë derogim është lejuar në përputhje me 2.11, **OSSH** dhe (apo) **Përdoruesi** (varësisht nga rasti) do të lirohet nga obligimet e veta për të vepruar në përputhje me dispozitat e aplikueshme në **Kodit të Shpërndarjes**, dhe nuk do të ketë ndonjë detyrim për dështimin për të qenë në përputhje me ndonjë dispozitë alternative ashtu siç është përcaktuar në derogim.

2.11.8 **OSSH** duhet të:

- a) mbajë regjistrin e të gjitha derogimeve të cilat janë pranuar, identifikimi i personit në emër të të cilit është pranuar derogimi, dispozita relevante e **Kodit të Shpërndarjes** dhe periudha e derogimit; dhe

- b) me kërkesë të ndonjë **Përdoruesi**, të sigurojë një kopje të një regjistri të tillë të derogimeve për **Përdorues** të tillë.

2.12 Mosmarrëveshjet

2.12.1 Procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje ndërmjet **Përdoruesve** dhe **OSSH-së**, mosmarrëveshja do të zgjidhet duke iu nënshtruar **procedurës për zgjidhjen e kontesteve** në sektorin e energjisë të nxjerrë dhe aprovuar nga **ZRrE**. Në rast mospërputhjeje ndërmjet dispozitave të këtij Kodi dhe akteve të tjera nën ligjore të miratuara nga **ZRrE**, kjo e fundit vendos për dispozitat që do të përdoren.

2.13 Administratori i Kodit

2.13.1 **OSSH** duhet të veprojë si administrator kodi dhe si i tillë duhet të ndërmarrë të gjitha funksionet e detajuara më poshtë në mënyrë profesionale, në afatin kohor dhe në mënyrë jo-diskriminuese.

2.13.2 Funksionet e administratorit të kodit do të përfshijnë si më poshtë:

- Mbajtjen e kopjes kryesore të azhurnuar të **Kodit të Shpërndarjes** duke siguruar se janë përfshirë të gjitha rishikimet e miratuara në të;
- Publikimin (shpalljen) e versionit aktual të miratuar në faqen elektronike zyrtare;
- Publikimin (shpalljen) e ndryshimeve të propozuara në faqen elektronike zyrtare (për konsultime);
- Publikimin (shpalljen) e ndryshimeve të miratuara në faqen elektronike zyrtare;
- Informimin me shkrim të të gjithë **Përdoruesit**, për këtë informacion se ka pasur ndryshime të propozuara, të miratuara ose versione të reja të **Kodit të Shpërndarjes** në faqen elektronike zyrtare.

Kapitulli III

3 Përcaktimi i Termave dhe Definicionet

3.1 Në Kodin e **Shpërndarjes** fjalët dhe shprehjet e përdorura do të kenë kuptimet si më poshtë:

Termi	Përcaktimi
AC	Rryma Alternative (Tensioni alternativ)
Aplikantët e Sistemit të Shpërndarjes	Person juridik, Përdorues aktual ose i ardhshëm i Sistemit të Shpërndarjes që aplikon për leje për t'u kyçur ose për të modifikuar lidhjen ekzistuese në Sistemin e Shpërndarjes .
Aplikimet për kyçje në Sistemin e Shpërndarjes	Dokumente të plotësuara nga Përdoruesit potencial që kërkojnë qasje për kyçje në Sistemin e Shpërndarjes , ose nga Përdoruesit ekzistues për të modifikuar kyçjen ekzistuese. Me qëllim që të marrë miratimin e OSSH -së për kyçje, dokumentet përgatiten sipas dispozitave të këtij Kodi.
DC	Rryma njëkahore (tensioni njëkahor)
Defektet	Defekti është një fenomen që ndodh për shkak të arsyeve të brendshme dhe të jashtme dhe shkakton deformimin e parametrave të energjisë elektrike ose ndërprerjen e funksionimit për një periudhë të caktuar kohe të një ose më shumë elementeve, që nga ana tjetër çojnë në ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike.
Demarkacioni	Kufijtë e lejuar të lëvizjes së personave në objektet elektroenergjetike
Diagrami i ngarkesës	Lakorja e ngarkesës gjatë çdo ore (00 – 24 orë) për një ditë, ose një periudhë tjetër për një konsumatorë, drejtim apo stabiliment etj.
Energjia e Dukshme	Energjia e Dukshme nënkupton integralin e Fuqisë së Dukshme në respekt të kohës e matur me VA dhe shumëfishët e tij.
Energjia elektrike aktive (Wh), (KWh), (MWh), (GWh), (TWh)	Energjia Elektrike është fuqia aktive që gjenerohet apo kalon në një qark elektrik gjatë një intervali kohe, duke qenë integrali i caktuar i fuqisë aktive me kufij kohor.
Energjia Elektrike Reaktive (VARh)	Energjia Elektrike reaktive është integrali i caktuar me kufij kohor i fuqisë reaktive .
Faktori i Fuqisë	Raporti i fuqisë elektrike aktive (W) me fuqinë e dukshme (VA) ($\cos\phi$). Vlera minimale e lejuar e $\cos\phi$ është 0.95

Frekuenca Nominale	Numri i periodave të rrymës alternative për sekondë e shprehur në Hz në frekuencën në të cilën operon normalisht sistemi 50 Hz.
Fuqia e Dukshme	Fuqia e Dukshme nënkupton prodhimin e vlerës efektive të rrymës s dhe vlerës efektive të tensionit. Për qarqet e sistemeve AC paraqet rrënjën katrore të katrorëve të fuqisë aktive dhe reaktive dhe e matur me kVA dhe shumëfishve të tij
Fuqia e Instaluar e Gjeneruesit Elektrik	Kapaciteti nominal i fuqisë aktive që mund të japë një Gjenerues i Energjisë Elektrike bazuar mbi dokumentacionin e prodhuesit (certifikatën e prodhuesit), i cili është shkruar në etiketën përkatëse të prodhuesit.
Fuqia Elektrike Aktive (W), (KW), (MW), (GW)	Produkti i tensionit dhe rrymës dhe kosinusit të këndit ndërmjet tyre. $P=(U \times I) \times \cos\phi$ ose shkalla me të cilën transferohet energjia.
Fuqia Elektrike Reaktive (VAr)	Produkti i tensionit dhe rrymës dhe sinusit të këndit të fazës ndërmjet tyre. $Q=(U \times I) \times \sin\phi$
Fuqia Maksimale e Gjeneratorit Elektrik	Maksimumi i mundshëm i fuqisë që është në gjendje të japë Gjeneruesi i Energjisë Elektrike në kushte të caktuara mekanike dhe elektrike të tij.
Furnizuesi	Person juridik ose kompani e licencuar që blen dhe shet, Energji Elektrike për furnizim të konsumatorëve në bazë të legjislacionit në fuqi.
Gjenerues (Prodhues)	Një person apo kompani që ndërmerr aktivitetin e pronësimit, kontrollimit ose operimit të njësive gjeneruese dhe që gjeneron energji sipas licencës.
Gjenerues Elektrik	Një tërësi godinash me disa pajisje mekanike dhe elektroenergjetike të caktuara, të cilat kanë si destinacion bazë gjenerimin e Energjisë Elektrike.
Gjenerues vetë-prodhues	Është përdoruesi me njësi gjeneruese që prodhon energji elektrike, kryesisht për përdorim vetjak.
Gjeneruesi i Lidhur me Rrjetin e Shpërndarjes	Gjenerator Elektrik me njësi gjenerimi të lidhur direkt në Rrjetin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.
Gjeneruesit e Pavarur	Personi apo kompania e cila gjeneron energji elektrike përfshirë edhe konsumatorët me gjenerim vetanak, të cilët janë direkt të kyçur në Sistemin e Shpërndarjes të OSSh-së.
Harmonikët	Rryma sinusoidale me frekuencë të njëjtë me shumëfishat numerik të frekuencës nominale.
Humbjet Teknike të Energjisë	Humbjet teknike të Energjisë Elektrike në një element rrjeti që janë të barabarta me diferencën mes Energjisë Elektrike hyrëse në element dhe Energjisë Elektrike që del nga elementi.
I izoluar	Procesi i arritjes së shkëputjes së pajisjes nga një pjesë e sistemit.
IEC	Komisioni Elektroteknik Ndërkombëtar (International Electrotechnical Commission)
Injektimi nga Rrjeti i Transmisionit	Kalimi i Energjisë Elektrike në Sistemin e Shpërndarjes nga Sistemi i Transmisionit në pikat e kyçjes midis tyre.

Kodi i Shpërndarjes	Është tërësia e rregullave teknike, që rregullojnë funksionimin e rrjetit të shpërndarjes dhe që vendosin kushtet dhe termat e shërbimit të OSSH-së për konsumatorët.
Konsumatori fundor (tarifor)	Konsumatori që blen energji elektrike për përdorim vetjak.
Konsumatori i Privilegjuar	Konsumatori që ka të drejtë të zgjedhë, për nevojat e tij vetjake, furnizuesin e licencuar të Energjisë Elektrike
KQKO	Komisioni Qeverisës i Kodeve Operacionale
Kufijtë e Pronësisë	Kufijtë mes Sistemit të Shpërndarjes dhe pajisjeve në pronësi të Përdoruesit.
Kushtet e Ngjarjes	Kushte operimi për një instalim të veçantë elektrik me një ose me shumë defekte që dëmtojnë operimin e Sistemit të shpërndarjes ose ndërpresin furnizimin me energji elektrike.
Kushtet Teknike për Kyçje	Dokument i lëshuar nga OSSH që lejon lidhjen e aplikantit me Sistemin e Shpërndarjes
KVA	Kilovolt-amper
Kyçja	Kyçja mes dy objekteve/sistemeve apo Përdoruesve të Sistemit të Shpërndarjes.
Licencë	Ka kuptimin si në Nenin 3 të Ligjit për Energjinë dhe Nenin 2 të Rregullit mbi Licencimin e aktiviteteve Energjetike në Kosovë.
Lidhja e shkurtë	Lidhja e shkurtë është ndodhia për shkak të dëmtimeve të ndryshme ose veprimeve të gabuara që lidhin elementet mes dy pikave me potenciale të ndryshme.
Ligji i Energjisë Elektrike	Është ligji aktual i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës
Luhatja (Oscilimi)	Perceptimi në mënyrë vizuale i krijuar nga një luhatje e lehtë që reflektohet në ndriçim ose shpërndarja spektrale e të cilit luhatet me kalimin e kohës.
Luhatjet e Tensionit	Një seri ndryshimesh të shpejta tensioni që mund të jetë e rregullt ose e çrregullt.
Marrëveshja e Kyçjes	Një marrëveshje dypalëshe në mes OSSH-së dhe çdo Përdoruesi të Sistemit të Shpërndarjes që përmban tërësinë e kushteve për kyçjen në Sistemin e Shpërndarjes.
Matja Tarifore	Sistemi i matjes së energjisë elektrike që përbëhet prej pajisjeve matëse dhe pajisjeve për grumbullimin e të dhënave, në bazë të të cilave furnizuesi i energjisë elektrike bënë llogaritjen.
Mbrojtja	Masa për parandalimin e kushteve jo normale në Sistemin Elektroenergjetik , zbulimin e defekteve dhe aktivizimin e alarmeve dhe dhënieve të sinjaleve, deri në shkëputjen e elementit të defektuar.
Mbrojtja Ndhimëse	Sistemi mbrojtës që do të ndërpret një ndërpres ose mekanizma të tjerë që ndërpresin rrymën e lidhjes së shkurtë në mungesë të operimit të mbrojtjes, të një sistemi tjetër mbrojtje.

Mirëmbajtja	Procesi i gjithë veprimeve teknike dhe organizative të kryera për elementet e Sistemit Elektroenergjetik gjatë periudhës së mirëmbajtjes me qëllim që të rikuperohen aftësitë e tyre përforcuese për funksionet e planifikuara.
Ndarësi	Një mekanizëm që siguron në pozicion të hapur një shkëputje të dukshme të një qarku elektrik .
Ndërprerjet e Planifikuara	Janë ndërprerjet e furnizimit me Energji Elektrike për shkak të mungesës së gjenerimit, mbingarkesës së elementeve të Sistemit Elektroenergjetik, përveçse kur është ndërprerje e detyruar, si dhe ndërprerjet për mirëmbajtjet e planifikuara.
Ndërprerjet për shkak të Defekteve në Sistemin Elektroenergjetik	Ndërprerje e furnizimit me energji elektrike për shkak të defekteve të elementeve të Sistemit Elektroenergjetik (si linjat, transformatorët e nënstacioneve, njësitë gjeneruese, etj.).
Ndërpresja e Qarkut	Një pajisje mekanike kyçëse/shkyçëse e aftë të ndërpresë rrymat në kushte normale të qarkut si dhe të përcjellë dhe të ndërpresë për një periudhë të caktuar kohe rrymën në kushte të veçanta jonormale të qarkut, si ato të qarkut të lidhjes së shkurtër.
Ngarkesa	Fuqia aktive, fuqia reaktive ose fuqia e dukshme e gjeneruar, transmetuar apo e shpërndarë.
Ngarkesa (konsumi)	Nëse nuk jepet ndryshe, ngarkesa e shprehur në MW ose MVA _r e Energjisë Elektrike Aktive dhe Reaktive.
Ngarkesa e Pikut (MW)	Maksimumi i vlerës së ngarkesës në MW i regjistruar brenda një periudhe kohore specifike.
Ngarkesa Maksimale	Ngarkesa maksimale do të thotë vlera maksimale e kVA të tërhequr në pikën matëse të furnizimit të konsumatorit në pronë të tij gjatë çdo periudhe kohore prej 15 minutave ashtu siç është përcaktuar nga ZRrE .
Ngarkesa Maksimale e Njëkohshme	Për një periudhë të caktuar kohore, shuma e të gjitha ngarkesave individuale për gjatë tërë pikave shkëmbyese në Ssh jep si rezultat kërkesën e njëkohshme të OSSH -së. Për një muaj (30 ditë kjo do të llogaritet për intervale kohore prej 15 minutash si: $4 \cdot 24 \cdot 30 = 2880$ periudha).
Ngarkesat e Çrregullta	Ngarkesa që kanë mundësi të krijojnë harmonikë , luhajtje ose mungesë balance në sistem.
Ngjarja	Një ndodhi e paplanifikuar apo e papërcaktuar që ndodh në Sistem, e që përfshin përshkrimin e përgjithshëm, defektet, incidentet dhe shkatërrimet.
Njësia Gjeneruese	Çdo njësi gjenerimi që gjeneron Energji Elektrike
Normat	Standardet, kodet, rregullat, vendimet dhe dokumente të tjera normative të vendosur me ligje, akte nën-ligjore, rregullore, urdhëresa, dokumente të tjera zyrtare dhe kontrata.
Objektet e Sektorit Elektroenergjetik	Një tërësi godinash , ndërtesash dhe pajisjesh të ndryshme të projektuara për të gjeneruar, transmetuar dhe shpërndarë Energji Elektrike.

Operatori i Tregut	Është personi juridik që është përgjegjës për organizimin dhe administrimin e tregut të energjisë elektrike dhe barazimin përfundimtar mes gjeneruesve, furnizuesve dhe konsumatorëve.
Operimi	Një veprim i planifikuar i kryer në Sistemin e Shpërndarjes.
OSSH	Një person fizik ose juridik që është përgjegjës për operimin, sigurimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Sistemit të Shpërndarjes dhe të sigurojë që sistemi t'i përmbushë nevojat për shpërndarjen e energjisë elektrike.
OST	Nënkupton Operatorin e Sistemit të Transmisionit , sipas Nenit 3 të Ligjit për Energjinë Elektrike.
Pajisja e përtokëzimit	Një pajisje e fiksuar ose portative për sigurimin e një kyçjeje në mes një përçuesi dhe tokës.
Palët	Një Gjenerues , Tregtar ose palë tjetër që është përdorues i Sistemit të Shpërndarjes
Përcjellja e të Dhënave të Ngarkesës	Përcjellja e të Dhënave të Ngarkesës është databazë e vlerës së ngarkesës e definuar në W, VAr ose VA (me shumëfishat e tyre) për çdo interval kohor të parapërcaktuar.
Përdoruesi i Sistemit të Shpërndarjes	Furnizuesi publik, Furnizuesit e pavarur, Gjeneruesit e Pavarur të lidhur me Rrjetin e Shpërndarjes, Konsumatorët tarifor , dhe Konsumatorët e Privilegjuar të lidhur direkt me rrjetin e shpërndarjes si dhe çdo person tjetër fizik ose juridik që përfiton nga shërbimet e rrjetit të shpërndarjes.
Përdoruesit Kryesor	Përdoruesit kryesorë janë: Gjeneruesit me fuqi të instaluar mbi 100 KW të lidhur drejtpërdrejt me Sistemin e Shpërndarjes si dhe të gjithë klientët e lidhur në Sistemin e Shpërndarjes në tension të mesëm.
Periudha e Ngarkesës	Periudhë e ngarkesës do të thotë periudhë gjatë së cilës fuqia aktive, reaktive ose e dukshme janë integruar ashtu që të prodhojnë vlerën mesatare të ngarkesës. Për qëllime të vendosjes (marrëveshjes) çdo periudhë e ngarkesës duhet të jetë në kohë zgjatje prej 15 ose 30 minutash dhe që do të fillojë nga ora 0.00 dhe në përputhje me tarifat e aplikuara.
Pika e Kyçjes	Pika fizike në të cilën instalimet e Përdoruesit të Sistemit të Shpërndarjes lidhen me Sistemin e Shpërndarjes.
Pika e Furnizimit nga Sistemi i Transmisionit	Një pikë lidhjeje mes Sistemit të Transmetimit dhe Sistemit të Shpërndarjes ose mes Sistemit të Transmetimit dhe një Përdoruesi të lidhur direkt në Sistemin e Transmetimit .
Pika e Matjes	Pika e matjes është vendi fizik ku është instaluar sistemi i matjes së energjisë elektrike dhe ku sistemi i matjes plotëson të gjitha kushtet teknike dhe të saktësisë sipas Kodit të Matjes së Energjisë Elektrike. Pika fizike e matjes përcaktohet plotësisht nga marrëveshjet midis Palëve.

Pika e Përbashkët	Pika në Sistemin e Shpërndarjes që është elektrikisht më afër me Pikën e Lidhjes dhe nga e cila lidhen ose mund të lidhen ngarkesa të klientëve të tjerë.
Procedurat për Mosmarrëveshjet	Procedurat e përshkruara në “Rregullin për Zgjidhjen e Kontesteve”, të aprovuar nga ZRrE.
Prodhuesit e Pavarur të Energjisë Elektrike	Gjeneruesit e Energjisë Elektrike të ndarë nga Sistemi Elektroenergjetik që prodhojnë Energji Elektrike për përdorimin e tyre, ose për shitje tek klientë të veçantë ose për shitje në Sistemin Elektroenergjetik.
Protokolli	Protokolli është softueri i përdorur për shkëmbimin e informatave me pajisjet e jashtme ose pajisjeve për pikën e shkëmbimit.
Qasja në Sistemin e Shpërndarjes	E drejta e subjekteve të licencuara që gjenerojnë ose furnizojnë energjinë elektrike si dhe e drejta e konsumatorëve të energjisë elektrike të kyçen dhe të përdorin, sipas legjislacionit në fuqi, shërbimet e sistemit të shpërndarjes .
Qendra Nacionale Dispečerike	Qendra nga ku bëhet operimi dhe përcjellja e Sistemit Elektroenergjetik duke marrë parasysh programimin dhe ruajtjen e sigurisë operative dhe parametrave të cilësisë sipas kushteve teknike.
RAT	Rregullimi Automatik i Tensionit
Rrjeti i Transmisionit të Energjisë Elektrike	Rrjeti i Transmisionit të Energjisë Elektrike në nivelet 110 kV, 220 kV, 400 kV që mundëson transmetimin e sasive të mëdha të energjisë në distanca të largëta.
Rryma e Lidhjes së Shkurtër	Rryma që qarkullon në një qark të shkurtër në një pikë të caktuar në Sistemin Elektroenergjetik dhe që mund të shprehet me kA.
Saktësia e Përgjithshme	Kombinimi i saktësisë së njehsorit, pajisjeve përcjellëse për transformatorët matës si dhe përçuesit për sistemin matës.
SCADA (Supervisory Control and Data Acquisition)	Sistemi i Kontrollit dhe Mbledhja e të Dhënave, sistemi kompjuterik në kohë reale që përdoret për të monitoruar dhe kontrolluar Sistemin e Transmisionit apo Shpërndarjes.
Sektori Elektroenergjetik	Bashkësia e aktiviteteve të planifikimit, zhvillimit, ndërtimit, përdorimit dhe mirëmbajtjes për instalimin e centraleve të Gjenerimit, Transmetimit, Shpërndarjes, Sistemeve/objekteve të Konsumatorëve të Privilegjuar, Furnizuesit e Energjisë Elektrike dhe Linjat e Interkoneksionit për import-eksport, tranzit dhe shkëmbimet me vendet fqinje.
Shpërndarësi i Energjisë Elektrike	Çdo person ose subjekt juridik i licencuar për shpërndarje të energjisë elektrike sipas legjislacionit në fuqi, me një nivel tensioni më të ulët se 110 kV.

Shpërndarja	Është transporti i energjisë elektrike në sistemet shpërndarëse të tensionit të mesëm dhe të ulët, duke pasur parasysh shpërndarjen deri te konsumatori fundor.
Shqyrtimet (Komisionimi)	Procesi përfundimtar i testimit të një pjese të Sistemit të Shpërndarjes para se ajo pjesë e Sistemit të vihet në punë.
Sistemi Bazik Kompjuteristik	Sistemi Bazik Kompjuteristik nënkupton përdorimin e të dhënave që shkarkohen nga njehsorët matës nëpërmjet të Qendrës Grumbulluese të të Dhënave ose nëpërmjet rrjetës komunikuese nga largësia dhe i shkarkon në Format Standarde që më vonë përdoren për kalkulime, analizë dhe paraqitje të ndryshme
Sistemi i Shpërndarjes	Sistemi i Shpërndarjes përfshin zbarrat, pajisjet kyçëse/shkyçëse dhe transformatorët në nënstacionet 110/35/20/10 kV, si dhe të gjithë elementet në nivel tensioni më të ulët se 110 kV në pronësi të OSSh
Sistemi i Transmisionit	Sistemi i Transmisionit të Energjisë Elektrike është një tërësi linjash elektrike të tensionit të lartë (110 kV, 220 kV, 400 kV), interkoneksionesh, transformatorësh elektrik ose çdo instalim tjetër, funksioni i të cilëve përfshin transmetimin e energjisë elektrike.
Tensioni i Lartë	Tensioni në nivelin nga 110 kV e lartë.
Tensioni i Mesëm	Tensioni në nivelin nga 35 kV deri në 1 kV.
Tensioni i Ulët	Tensioni në nivelin nën 1 kV.
TMRR dhe TMT	Nënkupton Transformatorët matës të Rrymës (TMRR) dhe Transformatorët matës të Tensionit (TMT) .
Tokëzimi	Një mënyrë për të siguruar një lidhje në mes përcjellësve dhe pajisjeve elektrike dhe tokës, nëpërmjet një pajisje tokëzimi.
Trafostacioni (Nënstacioni)	Tërësia e stabilimenteve elektroenergjetike, funksioni i të cilave është të transformojë dhe të transmetojnë Energji Elektrike nga një rrjet në një rrjet tjetër me nivele të ndryshme tensioni.
Tregu i Energjisë Elektrike	Aranzhimet tregtare komerciale të Energjisë Elektrike në Kosovë në përputhje me Ligjin për Energjinë dhe Ligjin për Energjinë Elektrike.
Urdhri Operativ	Urdhër i detyrueshëm për njësinë pritëse që lëshohet nga Qendra Nacionale Dispeçerike sipas rregulloreve në fuqi. Urdhrrat transmetohen me telefon dhe fakse ose pas instalimit të sistemit SCADA nëpërmjet mesazheve digjitale.
Veprimi Operativ	Veprime nga njësi që merr Urdhrin Operativ të nxjerrë nga Qendra Nacionale Dispeçerike ose Qendra Dispeçerike e Shpërndarjes, si dhe veprimet e programuara nga Palët që ndikojnë në funksionimin e Sistemit Energjetik..
ZRrE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë

Kapitulli IV

4 Planifikimi i Sistemit të Shpërndarjes

4.1 Hyrje

4.1.1 Planifikimi i **Sistemit të Shpërndarjes** specifikon kriterin teknik dhe të dizajnit si dhe procedurat që duhet të përputhen nga **OSSH** në Planifikimin dhe Zhvillimin e **Sistemit të Shpërndarjes**. Gjithashtu aplikohet tek **Përdoruesit** për planifikimin dhe zhvillimin e instalimeve të tyre deri në atë masë që ata kanë ndikim në **Sistemin e Shpërndarjes**.

4.1.2 Kërkesat e **Përdoruesve** mund të ndikojnë në përforcimin, apo zgjerimin, e **Sistemit të Shpërndarjes** dhe **Transmisionit**, respektivisht në përforcimin apo zgjerimin e kapacitetit ndërlidhës të **OSSH-së** dhe **OST-së**, të një pune të tillë që është identifikuar në mënyrë të duhur nga **OSSH**.

4.1.3 Koha e kërkuar për planifikimin dhe zhvillimin e **Sistemit të Shpërndarjes** dhe ndonjë zhvillimi të rëndësishëm i cili është i ndërlidhur me **Sistemin e Transmisionit**, do të varet nga lloji dhe masa mbështetëse e domosdoshme dhe (apo) dinamika e punëve, koha e kërkuar për marrjen e lejeve për planifikim, duke përfshirë edhe ndonjë diskutim verbal të mundshëm, dhe shkalla e kompleksitetit për ndërmarrjen e punëve të reja derisa është duke u mirëmbajtur siguria dhe kualiteti i kënaqshëm i furnizimit.

4.1.4 Referenca e bërë në Planifikimin e **Sistemit të Shpërndarjes** do t'iu shërbejë si informacion apo këshillë **OSSH-së** dhe **Përdoruesve**. Për shmangien e dyshimit, përveç nëse kërkohet ndryshe nga konteksti, informacioni i tillë apo këshilla duhet të ipet nga **OSSH** sa më shpejt që është e mundshme duke marrë parasysh kërkesën e **Përdoruesit** (ose gjatë procesit të aplikimit për **kyçje** ose të kundërtën).

4.2 Objektivat

4.2.1 Objektivat e Planifikimit të **Sistemit të Shpërndarjes** janë që të:

- a) Mundësoj të planifikohet, të dizajnohet dhe të ndërtohet **Sistemi i Shpërndarjes** që të operoj në mënyrë sa më ekonomike, mirë dhe të sigurt;
- b) Lehtësoj përdorimin e **Sistemit të Shpërndarjes** nga **përdoruesit** dhe të specifikojë standardin e kualitetit të shërbimit që duhet ofruar;
- c) Të ofroj informacion të mjaftueshëm për **Përdoruesin** që të vlerësojë mundësitë për **kyçe** dhe të planifikojë dhe zhvillojë instalimin e tij, që të jetë i përshtatshëm me **Sistemin e Shpërndarjes**; dhe
- d) Unifikojë formularët e kërkesave të të dhënave të Planifikimit të Sistemit.

4.3 Qëllimi

4.3.1 Planifikimi dhe zhvillimit i **Sistemit të Shpërndarjes** ka qëllimet si në vijim:

- a) Të hartojë planin e zhvillimit perspektiv të **Sistemit të Shpërndarjes**, për të qenë i aftë të shpërndajë energjinë elektrike në sasi dhe kualitet të kërkuar prej **Përdoruesve**.
- b) Të përcaktojë operimin e **Sistemit të Shpërndarjes** sipas kushteve të sigurisë, si dhe të krijoj siguri në shpërndarjen e Energjisë Elektrike në nivelet e kërkuara të kualitetit.
- c) Të orientojë dhe nxisë investimet me efikasitet në **Sistemin e Shpërndarjes**, nëpërmjet inicimit të procedurave të nevojshme si dhe të mbledh e të përpunoj informacionet e nevojshme për hartimin e planit të zhvillimit të sistemit.

4.3.2 **Përdoruesit** tek të cilët aplikohet Planifikimi i **Sistemit të Shpërndarjes** janë ata që e përdorin apo synojnë ta përdorin **Sistemin e Shpërndarjes**:

- a) Të gjithë **gjeneratorët** dhe **gjeneruesit** e pavarur;
- b) Të gjithë **Konsumatorët** e lidhur në **Sistemin e Shpërndarjes**; dhe
- c) **Furnizuesit**.

4.3.3 Hartimi i Planit të Zhvillimit për **Sistemin e Shpërndarjes**

Hartimi i planit të zhvillimit të **Sistemit të Shpërndarjes** bazohet në të dhënat e mëposhtme:

- a. parashikimet e ngarkesës për çdo vit të bëra nga **furnizuesit** (duke përfshirë diagramet e llojeve të ngarkesës për ditë të veçanta);
- b. parashikimin e prodhimit të energjisë elektrike nga gjeneruesit ekzistues pesë (5) vjet;
- c. niveli i sigurisë të përcaktuar në të gjithë **Sistemin e Shpërndarjes** dhe në secilën nyje të përshtatet me normat në fuqi;
- d. Strategjinë për zhvillimin e infrastrukturës telekomunikuese për monitorim dhe kontrollim nga distanca, përgjegjësi e cila i përket **OSSH-së**.

4.4 Kriteret e Planifikimit

4.4.1 Plani i zhvillimit të **Sistemit të Shpërndarjes** do të përgatitet në bazë të studimit të zhvillimit perspektiv, për një kohëzgjatje mesatare 5 vjeçare për **rrjetin e shpërndarjes**. Plani i zhvillimit të **Sistemit të Shpërndarjes** merr parasysh:

- a) sigurinë, operimin e qëndrueshëm dhe zbatimin e standardeve për shërbim cilësor të shpërndarjes së Energjisë Elektrike
- b) përdorimin e kapaciteteve të **Sistemit të Shpërndarjes** në optimumet ekonomike;
- c) zgjedhjen e alternativës së zhvillimit me efikasitet maksimal ekonomik;
- d) përcaktimin e operimit ekonomik të **Sistemit të Shpërndarjes** në kushtet e ngarkesës së paqëndrueshme;
- e) respektimin e normave të sigurisë si dhe ligjet për ndalimin e zjarrit.

4.4.2 Planifikimi i zhvillimit të **Sistemit të Shpërndarjes** synon gjithashtu të kufizojë ndikimin negativ të shkaktuar në mjedis, direkt apo indirekt kryesisht nga shkaktarët si në vijim:

- ndotjet kimike (vaji, gasi, mediumet ftohëse të ndryshme, etj.);
- ndikimi i mjedisit agresiv në sistem (lagështia, ngricat e tepërta, akulli, kripërat, erërat e forta, ajri i turbullt në rrymimet vertikale etj.);
- parashikimi në planifikim i masave në fatkeqësitë natyrore (tërmetet, përmbytjet);
- shkarkesat atmosferike (radioaktive, etj.);

4.5 Kriteret për Verifikimin e Dimensionimit të Sistemit të Shpërndarjes

- 4.5.1 Verifikimi i dimensionimit të **Sistemit të Shpërndarjes** do të kryhet në pajtueshmëri me normat teknike në fuqi, duke marrë parasysh tri kriteret e mëposhtme për studim:
- kriterin ekonomik;
 - kriterin e qëndrueshmërisë termike në operimin afatgjatë;
 - kriterin e qëndrueshmërisë termike dhe dinamike në regjimin e **lidhjes së shkurtër**.

4.6 Standardet e Dizajnit

4.6.1 Frekuenca

- 4.6.1.1 **Frekuenca** e Sistemit është jashtë kontrollit të **OSSH**-së, sidoqoftë brezi standard i **frekuencës** standarde është i definuar në **Kodin e Rrjetit**.

4.6.2 Tensioni

- 4.6.2.1 **Sistemi Shpërndarjes** përfshinë rrjetin i cili operon në tensionet nominale në vazhdim:

Tensioni i ulët (TU)	230 volt-faza në neutral 400 volt-fazë për fazë
Tensioni i Mesëm (TM)	6.300 volt (6.3 kV) 10.000 volt (10 kV) 20.000 volt (20 kV) 35.000 volt (35 kV)

- 4.6.2.2 **OSSH** do të operojë **Sistemin e Shpërndarjes** ashtu që të sigurojë që tensioni nëpër terminalët e sistemit të furnizimit, siç është definuar në standardin **IEC 61000**, të përputhet me këtë standard. Toleranca e brezit të **tensionit të nivelit të ulët** do të jetë 230 V +10%; -15%. Tensioni rezultues në pika të ndryshme në sistem varet nga disa faktorë, por në pikën lidhëse me **konsumatorët** mund të pritet të jetë në përputhje me të dhënat në tabelën në vijim, në kushte stabile dhe normale të operimit.

Tensioni Nominal	Tensioni më i Lartë	Tensioni më i Ulët
230 V	253 V	195.5 V
400 V	440 V	340 V
6.3 kV	6.9 kV	5.7 kV
10 kV	11.1 kV	9.0 kV
20 kV	22.1 kV	18 kV
35 kV	38.5 kV	29.75 kV

4.6.2.3 **Sistemi i Shpërndarjes** dhe ndonjë lidhje e **Përdoruesit** në atë sistem do të dizajnohet për të mundësuar **Frekuencën Normale** të operimit dhe tensionet për furnizimin e konsumatorit për t'u përputhur me standardin Evropian EN 50160:1995 “ Karakteristikat e tensionit të energjisë së furnizuar nga Sistemi Publik Shpërndarës”. Karakteristikat e tensionit, frekuencës, devijimeve, pengesave, çekuilibrimin dhe **harmonikëve** janë paraqitur në standardin e aprovuar CENELEC.¹ Duhet të kihet parasysh se standardi përshkruan karakteristikat kryesore të tensionit i cili mund të pritët në терминаlet e furnizimit nën kushte normale të operimit.

¹ CENELEC -

4.6.3 **Kërkesat për Gjeneruesit e Pavarur të Energjisë të Lidhur Direkt në Sistemin e Shpërndarjes**

4.6.3.1 **Kodi i Shpërndarjes** aplikohet për gjithë **Gjeneruesit e Pavarur** ekzistues, ose të ardhshëm të lidhur direkt në **Sistemin e Shpërndarjes**, përfshirë **Gjeneruesit me Ko-gjenerim, Konsumatorët me Vetë - prodhim** si dhe **Gjeneruesit** që përdorin burime të ripërtëritshme të Energjisë.

4.6.3.2 **Gjeneruesit me gjeneratorë** në gatishmëri (stand-by) që janë të lidhur në **Sistemin e Shpërndarjes**, duhet të plotësojnë kërkesat e **OSSH-së** duke shmangur operimin në paralel me rrjetin. Këto kërkesa përshkruhen në **Marrëveshjen e Kyçjes. Gjeneruesit e lidhur direkt në Sistemin e Shpërndarjes** do të nisin diskutimet në një stad të hershëm të planifikimit, për të lejuar **OSSH-në** që të shqyrtojë ndikimin e **Njësisë Gjeneruese mbi Sistemin e Shpërndarjes**.

4.6.3.3 **OSSH** do të kërkoj plotësimin e kushteve për kyçjen e **Njësisë Gjeneruese** në një pikë të **Sistemit të Shpërndarjes**, ose të kërkojë rishikim të parametrave të ndërtimit ose parametrave teknik të **njësisë gjeneruese**, ose të vendosë disa kufizime me qëllim që të garantojë ruajtjen e sigurisë dhe cilësinë e standardeve të furnizimit. Në këtë rast, **OSSH** do të sigurojë informacion të mjaftueshëm shpjegues për të justifikuar plotësimin e kushteve të kërkuara. Të gjithë **Gjeneruesit** e kyçur direkt në **Sistemin e Shpërndarjes** do të sigurojnë **OSSH-së** të gjitha të dhënat dhe informacionin e kërkuar nga **OSSH** sipas afateve të përcaktuara në këtë **Kod të Shpërndarjes**.

4.6.4 **Të dhënat që kërkohen nga të gjithë Konsumatorët, përfshirë dhe Konsumatorët e Privilegjuar të lidhur në Sistemin e Shpërndarjes**

4.6.4.1 **Konsumatorët e lidhur në Sistemin e Shpërndarjes** duhet të sigurojnë **OSSH-së** të dhënat e mëposhtme, si dhe të gjitha të dhënat dhe informacionin e kërkuar nga **OSSH** sipas afateve të përcaktuara në këtë Kod:

- 1) **Kërkesën** për Energji aktive vjetore.
- 2) **Kërkesën** për Energji reaktive vjetore
- 3) **Kërkesën** për Energji maksimale vjetore.

- 4) **Ngarkesën** maksimale për çdo fazë.
- 5) Diagramin e **Ngarkesës**, ditët e Pikut.
- 6) Tensionin nominal të pikës ku furnizohet **ngarkesa**.

4.6.5 Kriteret për Tokëzim

4.6.5.1 Trajtimi i neutrit është i ndryshëm për tensione të ndryshme furnizuese. **Tokëzimi** i një pjese të instalimit të **Përdoruesit**, që është i lidhur me **Sistemin e Shpërndarjes**, do të plotësojë kërkesat e **Kodit të Shpërndarjes** si dhe legjislacionit në fuqi. Instalimi i tokëzimit të **Sistemit të Shpërndarjes**, do të jetë konform rregullave dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Trajtimet aktuale janë përshkruar më poshtë por këto mund të ndryshojnë në të ardhmen.

4.6.5.2 Instalimet elektrike të **konsumatorëve** të rinj të lidhur në **tensionin e ulët** do të mbrohen nga përçuesi mbrojtës elektrik i posaqëm, me sistemin e tokëzimit të tipit TT² në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullave Kombëtare (Shtetërore) për Instalimet Elektrike – Instituti për Standarde Elektro-Teknike të Republikës së Kosovës.

Kjo kërkon që përçuesit tokëzues të pajisjeve individuale të jenë të lidhur në pozicionin qëndror të lidhjes në afërsi me terminalen furnizuese në hyrje. Nuk lejohet asnjë tokëzim lokal i stabilimenteve apo pajisjeve brenda instalimeve.

4.6.5.3 Për tensionet e mesme aplikohen tokëzimet si në vazhdim:

<u>Tensioni</u>	<u>Trajtimi i neutrit</u>
10 kV	Neutri i izoluar apo neutri i lidhur përmes Rezistorit prej 20 Ω apo 40 Ω ashtu për të kufizuar Rëniet e rrymës një-fazore në tokëzim deri në 300 A.

² TT – Tera - Tera

- 20 kV **Tokëzimi** përmes një rezistori të 20 Ω i cili kufizon rëniet e rrymës në tokëzim deri në 600 A
- 35 kV **Tokëzimi** përmes një bobine shuarse të rrymave kapacitive të lidhjes më tokë (Induktansa serike) në trafostacionet me primar.
- 110 kV **Tokëzimi** në mënyrë efektive.

4.6.5.4 Me përjashtim të rregullit të **TU** ku lejohen tokëzimet e shumëfishta mbrojtëse, rrugët (mënyrat) e sekuençës së fazës me zero të shumëfishtë aktualisht janë të ndaluara në dizajnin e **Sistemit Shpërndarës**.

4.7 Transferimi i të Dhënave Planifikuese

4.7.1 Informatat e Planifikuara duhet të sigurohen nga Përdoruesit

4.7.1.1 **Përdoruesit e Sistemit të Shpërndarjes** do të ofrojnë të dhëna/informata të mjaftueshme ashtu siç mund të pritët në mënyrë të arsyeshme që të sigurohen kur kërkohet nga **OSSH**, për t'i mundësuar **OSSH**-së të veprojnë në përputhje me kërkesat në bazë të Licencës së **OSSH**-së.

4.7.1.2 **Përdoruesit e Sistemit të Shpërndarjes** (me fuqi të angazhuar mbi 15 kW) do të sigurojnë të dhëna për planifikim për periudha specifike kohore në të ardhmen, të freskuara çdo vjet sipas nevojës dhe duke përfshirë nevojat e projektuara të parashikimit të kërkesës, ndryshimet e parashikuara në kërkesën maksimale, apo kapaciteti i prodhimit, në mënyrë sa më të përshtatshme dhe të duhur. Të dhënat dhe kohëzgjatja gjatë së cilës kërkohen të dhënat, janë dhënë në Operimin e **Sistemit të Shpërndarjes** dhe Regjistrin e të dhënave teknike.

4.7.1.3 Përveç freskimeve periodike të informatave mbi planifikimin, **përdoruesi** duhet të sigurojë shënime adekuate të ndonjë ndryshimi të rëndësishëm të sistemit të tyre apo regjimit operativ, për t'i mundësuar **OSSH**-së që të përgatisë planet e veta për zhvillim dhe implementimin e ndonjë modifikimi të domosdoshëm në sistem. Me

rastin e ndryshimeve të pa planifikuara në Sistemin e **Përdoruesit** apo regjimin e operimit **Përdoruesi** do të njoftojë **OSSH**-në sa më shpejt që është e mundur për të siguruar marrjen e ndonjë mase të domosdoshme që mund të implementohet.

4.7.1.4 **Përdoruesit** do të sigurojnë detajet e kompensimit të **fuqisë reaktive** të stabilimentit të lidhur në **Sistemin e Shpërndarjes**, përveç atij të **Tensionit të Ulët** (me fuqi të angazhuar nën 15 kW) duke përfshirë karakteristikat nominale dhe kontrollimin e operimit.

4.7.1.5 Nga **Përdoruesit** do të kërkohet t'i sigurojnë **OSSH**-së të dhënat e detajeve të ndërlidhjeve në mes sistemit të tyre dhe të **Sistemit të Shpërndarjes** që mbulon parametrat e qarkut, ndërprerësve dhe aranzhimeve të mbrojtjeve të pajisjeve të lidhura drejtpërdrejtë apo që ndikojnë në **Sistemin e Shpërndarjes** për t'i mundësuar **OSSH**-së qasje në ndonjë ngatërrim të ndërlidhur me këto **pika të lidhjeve**.

4.7.2 Informatat që duhet Shkëmbyer

4.7.2.1 **OSSH** do të ofrojë informata të arsyeshme të kërkuara nga **Përdoruesi** i **Sistemit të Shpërndarjes** për dizajnin dhe karakteristikat tjera të **Sistemit Shpërndarës**.

4.7.2.2 Në rastin kur **OSSH** propozon për të bërë modifikime të caktuara në sistemin e vet apo kur ka marrë informatë nga **Përdoruesi** si më lartë nën 4.7.1, që mund të ndikojë në instalimet tjera të **Përdoruesit**, atëherë **OSSH** do të njoftojë **Përdoruesit** me propozimin duke ju nënshtruar ndonjë detyrimi (përmbajtje) të konfidencialitetit apo kohës.

4.7.2.3 **OSSH** do t'i sigurojë informatat me kërkesë të **Përdoruesve** lidhur me kushtet e rrjetit lokal për të ju mundësuar përcaktimin e mbrojtjes së kërkesave të tyre.

4.7.2.4 Kur instalimi i **Përdoruesit** është i lidhur në zbarra të **Sistemit të Shpërndarjes** mund të nevojitet shkëmbimi i detajeve të mjaftueshme për sa i përket **Kufirit të Pronësisë** së **Përdoruesit** dhe **OSSH**-së për të mundësuar vlerësimin e ndikimeve të përkohshme të mbitensionit. Kërkesa për informata mund të iniciohet nga **OSSH** apo **Përdoruesi**.

4.7.2.5 Informata mund të shkëmbehet në mes **OSSH**-së dhe **Përdoruesit** në nivelet e prishjeve në furnizim në zbarrat furnizuese apo **pikën e lidhjes** në **Sistemin e Shpërndarjes** në mënyrë të duhur, në formën e:

- Furnizimi nga lidhja me tokë dhe lidhja e shkurtë për lidhje një fazore dhe tre fazore.
- Raporti X/R^3 nën kushtet e prishjes së lidhjes tre fazore.

4.7.2.6 Midis **OSSH**-së dhe **Përdoruesit** lidhur me kapacitetet për transferim të **ngarkesës** kur **ngarkesat** mund të ofrohen nga pikat alternative furnizuese të **Përdoruesit**, atëherë kjo duhet të përfshijë proporcionin e **ngarkesës** të pranuar në kushte normale nga secila pikë e furnizimit dhe masat (manuale apo automatike) për transferim në kushte të ndërprerjes së planifikuar apo nga defektet.

4.7.3 Analizat e Planifikimit

4.7.3.1 Në mënyrë që të lehtësohen lidhjet e reja/modifikuara në **Sistemin e Shpërndarjes**, **OSSH** do të përgatisë (atëherë kur kërkohet), një kërkesë për një analizë e cila tregon implikimet e mundshme të ndonjë lidhjeje në pikë të caktuar në sistem.

4.7.3.2 Nën kushtet e Licencës së **OSSH**-së mund të vihet një detyrim pagesë e arsyeshme nga **OSSH** për analizën planifikuese. Detajet e këtyre detyrimeve pagesore do të përcaktohen në Procedurën mbi “Metodologjinë e Tarifave për Kyçje”, procedurë e cila do të zhvillohet nga **OSSH**-ja dhe aprovohet nga **ZRrE** siç është paraparë në Rregullin për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji..

³ X/R – Reaktansa /Rezistenca Omike

- 4.7.3.3 **Përdoruesit** apo **Përdoruesit** potencial do t'i sigurojnë **OSSH**-së informatat lidhur me pajisjet e propozuara përfshirë detajet e ngarkesës, aranzhimet e ndërlydhjeve, pika e propozuar e lidhjes dhe kërkesat për importim/eksportim.
- 4.7.3.4 Analizat normalisht do të jenë të përgatitura brenda 30 ditëve pas datës së pranimit të informatës apo marrëveshjes së personit i cili e bënë kërkesën për të paguar koston e studimit. Në rast të **Gjeneratorëve** apo **Konsumatorëve** industrial që kërkojnë lidhje, varësisht nga natyra dhe kompleksiteti i kërkesës, kjo periudhë mund të zgjatet në 90 ditë apo edhe 30 ditë tjera prej pranimit të informacionit së planifikimit nga ana **OSSH-së** për periudhën kohore më të gjatë.
- 4.7.3.5 Detajet e procedurave për aplikim për kyçje në **Sistemin Shpërndarës** do të përfshihen në “Metodologjinë e Tarifave për Kyçje” në **Sistemin e Shpërndarjes**.
- 4.7.3.6 Rregullat e aplikuara nga **OSSH** në përcaktimin e aplikacionit për kyçje janë të përcaktuara në “Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të **Sistemit të Shpërndarjes**”
- 4.7.3.7 Kur informatat e tilla janë në dispozicion, atëherë **OSSH** do të ofrojë një deklaratë mbi kapacitetet e tanishme dhe të ardhme, parashikimin e rrjedhave të fuqisë dhe ngarkimin e pjesës apo të pjesëve të **Sistemit të Shpërndarjes** i specifikuar në kërkesë dhe duhet të përfshijë nivelet e prishjeve në çdo një të Shpërndarjes të përfshira në kërkesë. **OSSH** mund të zbresë ndonjë detyrim nga dispozita e kësaj marrëveshjeje me miratim nga **ZRrE** mbështetur në çmimet e arsyeshme të caktuara nga **OSSH** me përgatitjen e kësaj deklaratë.
- 4.7.3.8 Afatet e dhëna në 4.7.3 janë vetëm afatet e planifikuara dhe nuk përbëjnë një detyrim legal. **OSSH** sidoqoftë do të bëjë përpjekjet e arsyeshme që t'i plotësoj ato.

Kapitulli V

5 Kushtet Teknike të Kyçjes në Sistemin e Shpërndarjes

5.1 Hyrje

5.1.1 Është e domosdoshme të kërkohet përmbushja e kriterit minimal të caktuar teknik, të dizajnit dhe atij operativ nga stabilimenti dhe aparatura e **Përdoruesit** në mënyrë që të mirëmbahet deri në atë masë që është e lejuar nga Praktika e Mirë Industriale, operimi stabil dhe i sigurt i **Sistemit të Shpërndarjes** për të mirën e të gjithë **Përdoruesve** dhe për mbrojtjen e **Sistemit të Shpërndarjes** dhe stabilimenteve të **Përdoruesit** dhe aparateve drejtë për drejtë të lidhur në **Sistemin e Shpërndarjes**.

5.1.2 **Kushtet e Kyçjes në Sistemin e Shpërndarjes** themelojnë parime dhe standarde të caktuara që kanë të bëjnë me dispozitat për **kyçjen**, metodën e **kyçjes** dhe standardet teknike dhe të performancës.

5.1.3 **Kushtet e Kyçjes në Sistemin e Shpërndarjes** specifikojnë informatën që duhet të sigurohet nga **Përdoruesi** për të siguruar që dispozitat adekuate mund të bëhen nga **OSSH** për **kyçjet** e reja apo rritjen e ngarkesës ekzistuese. Gjithashtu kjo aplikohet tek **Gjeneratorët** të cilët operojnë paralel me **Sistemin e Shpërndarjes**, ku **kyçje** është kërkuar .

Përdoruesit e ardhshëm duhet të paraqesin tek **OSSH** në kohë të gjitha detajet që janë paraqitur në këtë kapitull.

5.1.4 Në lidhje me **Kushtet e Kyçjes**, ekzistojnë **Marrëveshjet për Kyçje**, të cilat janë **marrëveshje bilaterale** në mes **OSSH** dhe secilit **Përdorues**, dhe e cila përmban detaje specifike për secilën **kyçje** të **Përdoruesve** dhe për përdorimin e **Sistemit të Shpërndarjes**. **Marrëveshja për Kyçje** kërkon që **Përdoruesi** dhe **OSSH** të veprojnë në përputhje me kushtet e **Kodit të Shpërndarjes**.

5.2 Objektivi

5.2.1 **Kushtet e Kyçjes** definojnë standardet minimale për menyrën e **kyçjes** në **Sistemin e Shpërndarjes** dhe standardet teknike, të dizajnit dhe ato të operimeve me të cilat **Përdoruesi** i cili **kyçet** në **Sistemin e Shpërndarjes** duhet të pajtohet.

5.2.2 **Kushtet e Kyçjes** specifikojnë aranzhimet teknike të kërkuara në **Kufirin e Pronësisë** në mes **Sistemit të Shpërndarjes** dhe instalimit të **Përdoruesit** dhe është e aplikueshme në të gjitha nivelet e tensionit të mbuluara nga **Kodi i Shpërndarjes**.

5.2.3 **Kushtet e Kyçjes** nënvizojnë llojin e sinjaleve dhe indikacioneve që do të kërkohen nga secili **Përdorues** për t'i lënë në dispozicion të **OSSH-së**.

5.3 Qëllimi

5.3.1 Qëllimi i këtij paragrafi është që të përmbushë objektivat e mëposhtme:

- a. Gjithë **Përdoruesit** ekzistues të **Sistemit të Shpërndarjes** ose ata të perspektivës të trajtohen në mënyrë të barabartë.
- b. Çdo **kyçje** e re nuk duhet të shkaktoj ndonjë efekt negativ tek **Përdoruesit** ekzistues, ose një **kyçje** e re nuk duhet të ndikohet nga efektet negative të **Përdoruesve** ekzistues.
- c. Të ndihmoj **Përdoruesit** e **Sistemit të Shpërndarjes** që të zbatojnë detyrimet e tyre dhe të sigurojnë operim dhe mirëmbajtje me cilësi të lartë të instalimeve të tyre.
- d. Të specifikoj qartë dhe në një format standard, detyrimet dhe përgjegjësitë për të gjithë **Përdoruesit** e **Sistemit të Shpërndarjes**, për çdo vend ku bëhet/modifikohet një **kyçje**.

5.4 Informata e Kërkuar për Kyçje

5.4.1 Për **kyçje** në **tensionin e ulët** për të shumtën rasteve është e mundur të vlerësohet se **kyçja** e propozuar është e pranueshme apo jo, dhe të përcaktohen aranzhimet e domosdoshme të furnizimit, prej analizave të të dhënave që do të tregohen në vazhdim.

Për **kyçje** në **tension të ulët** në **Sistemin e Shpërndarjes** kërkohen informacionet e mëposhtme:

- Emrin e objektit (vendi i konsumit);
- Vendndodhja e objektit, adresën, bashkëngjitjen e një harte të vendndodhjes në zonën respektive nëse kërkohet nga **Sistemi i Shpërndarjes**.
- Specifikën e aktivitetit (prodhimin, tregtimin, shërbimet, etj.)
- Llojin e **kyçjes** së kërkuar (një fazore ose tre fazore);
- **Fuqinë** e instaluar në KW;
- Projektin elektrik të instalimeve të **Përdoruesit** të bërë nga inxhinier elektrik të Licencuar;
- Deklaratën mbi konformitetin e instalimeve të brendshme të **Përdoruesit**;
- **Kërkesat** maksimale për KW ose kVA;
- **Kërkesën** vjetore për Energji Elektrike në KWh;
- Tipin dhe ngarkesën elektrike të pajisjes që do **kyçet**, (si numri dhe fuqia e motorëve, ndriçimi, etj.)
- Faktorin mesatar të fuqisë, me të cilin do të punojë konsumatori ($\cos\phi$);
- Datën kur kërkohet **kyçja**.

Nëse vlerësimi paraprak i këtyre të dhënave tregon se kërkohet më shumë informacion i detajuar, atëherë ai do të sigurohet nga **Përdoruesi/Konsumatori** respektiv i **OSSH-së** sipas kërkesës së **OSSH-së**.

Nëse një shqyrtim i parakohshëm i këtyre të dhënave tregon se në mënyrë të arsyeshme kërkohet një informacion më i detajuar atëherë duhet të dorëzohet një kërkesë tek **OSSH**.

- 5.4.2 Kriteret e informatave dhe kornizat kohore për vlerësimin dhe **kyçjen** duhet të përpilohen në një dokument të veçantë si në “Metodologjinë e Taksave për Kyçje” në **Sistemin e Shpërndarjes** Kjo gjithashtu duhet të përmbajë format e aplikimit të cilat forma **Përdoruesit** të cilët kërkojnë **kyçjen** apo zgjerimin në **Sistemit të Shpërndarjes** janë të obliguar t’i kompletojnë. Një kopje e këtij dokumenti vëhet në disponim me anë të një kërkesë drejtuar **OSSH-së**.
- 5.4.3 Për **kyçje** në **Tensionet e Mesme** aplikohen gjithashtu kushtet e 5.4.1. Përveç kësaj, informata në vazhdim mund të kërkohet ashtu siç është detajizuar në Regjistrin e të Dhënave Teknike.

a) Të gjitha llojet e kërkesave

Për kyçe në **Tension të Mesëm** do të kërkohen informatat e mëposhtme:

- Emri i objektit (vendi i konsumit);
- Vendosja (Përcaktimi/Vendndodhja) e objektit, adresa. Bashkëngjitur një skemë me vendndodhjen në zonën respektive;
- Specifika e aktivitetit (prodhimi, shërbimi, si dhe mënyra e punës, numri i turneve gjatë ditës, ditët e punës në javë etj.);
- **Fuqia** e instaluar në MW;
- Diagrami i **Ngarkesës**;
- Faktori mesatar i fuqisë me të cilin do të punojë konsumatori ($\cos\phi$);
- Projekti elektrik i instalimeve të **Përdoruesit** të bërë nga firma elektrike e Licencuar;
- Deklarata mbi konformitetin e instalimeve të brendshme të **Përdoruesit**;
- Nëse **Përdoruesi** është i lidhur dhe kërkon modifikim të lidhjes ekzistuese duhet të paraqesë: mënyrën me të cilën furnizohet objekti aktualisht (skema, karakteristikat, rrugët e furnizimit dhe mënyra e matjes së energjisë elektrike të konsumuar).
- Duhet dhënë gjithashtu një kopje e **Marrëveshjes se Kyçjes** të marrë më parë dhe skema e vendosjes së instalimeve të furnizimit me pikat ekzistuese marrëse dhe matëse;
- Kërkesën për **energji elektrike aktive** maksimale dhe minimale vjetore dhe 5 vjeçare;
- Kërkesën për **energji elektrike reaktive** maksimale dhe minimale vjetore dhe 5 vjeçare;
- Lloji i **ngarkesës** dhe marrëveshjet e kontrollit (p.sh. mënyra e lëshimit të motorit, etj.);
- **Ngarkesa** maksimale për çdo fazë;
- **Harmonikët** maksimal të tensionit dhe rrymës që mund të imponohen mbi **Sistemin e Shpërndarjes**;
- Detajet e variacioneve të ngarkesës ciklike ose ngarkesave luhatëse (si më poshtë);
- **Ngarkesat** ç'rregulluese

- Perspektet e përgjithshme të pajisjeve të reja të instaluar duke përfshirë detajet e **ngarkesave** shqetësuese. Këto janë **ngarkesa** që kanë potencialin të fusin harmonike, luhatje ose mungesë baraspeshe në **Sistemin e Shpërndarjes**;
- **Ngarkesat** Luhatëse;
- Të dhëna teknike për pajisjet që gjenerojnë fuqi reaktive nëse ka;
- Përgjegjësitë për kontrollin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve;
- Data kur kërkohet **kyçja**.

b) Ngarkesat penguese

Lista e përgjithshme e pajisjeve të reja të instaluar duke përfshirë detajet e **ngarkesave** penguese. Këto janë **ngarkesa** të cilat kanë potencial të paraqesin **harmonikë**, dridhje apo çekuilibrim në sistem. Kjo mund të ketë ndikim të kundërt në cilësinë e furnizimit të konsumatorëve tjerë. **Ngarkesat** penguese mund të jenë **ngarkesa** jo-lineare, konvertorë të fuqisë (rregullatorët) dhe **ngarkesat** me **kërkesë** me luhatje të gjerë. Lloji i informatës mbi **ngarkesën** e kërkuar për ngarkesat lëvizëse të fuqisë, pajisjet për saldim, **harmonikët** që krijojnë **ngarkesa** jo lineare dhe **pajisjet gjeneruese**, mund të merren nga **OSSH** me paraqitjen e kërkesës.

Në rast të kompensimit të pajisjes së ndërlidhur me **ngarkesat** penguese, duhet siguruar detajet dhe mënyrën e operimit për të siguruar përputhshmërinë me kufijtë e emetimit të specifikuar në 5.6.8.3.

C) Ngarkesat Luhatëse (Osciluese)

Detajet e ndryshimeve ciklike, atëherë kur aplikohet funksioni i ciklit, të **Fuqisë Aktive** dhe **Fuqisë Reaktive**, në veçanti:

- (i) shkallët e **ngarkimit** të **Fuqive Aktive** dhe **Reaktive**, të dyja duke u rritur dhe duke u zvogëluar;
- (ii) intervali më i shkurtër përsëritës kohor në mes luhatjeve të **Fuqisë aktive** dhe **Reaktive**; dhe
- (iii) madhësia e **ngarkesave** më të larta të hapit në **Fuqinë Aktive** dhe **Reaktive**, të dyja duke u rritur dhe duke u zvogëluar

- 5.4.4 Në disa raste, mund të kërkohet informacion më i detajuar për të lejuar vlerësimin e plotë të efektit të **ngarkesës së Përdoruesit** në **Sistemin e Shpërndarjes**. Informacioni i tillë mund të përfshijë treguesit e një modeli të selektuar të ndërtimit të **ngarkesës** dhe një program komisionues të propozuar. Ky informacion në mënyrë specifike do të kërkohet nga **OSSH** në rastin kur është e domosdoshme dhe do të sigurohet nga **Përdoruesi** brenda një kohe të arsyeshme.
- 5.4.5 **Përdoruesit** do të kontaktojnë **OSSH**-në paraprakisht nëse propozohet të bëhet ndonjë ndryshim i rëndësishëm në **kyçje**, linja elektrike apo pajisje elektrike, të instalojnë apo operojnë ndonjë pajisje prodhuese apo të bëjnë ndonjë punë tjetër që do të mund të ketë efektë në **Sistemin e Shpërndarjes** apo do të kërkojnë ndryshime në **kyçje**.
- 5.4.6 **Përdoruesit** duhet të paraqesin tek **OSSH** informatën e kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga **OSSH** në lidhje me natyrën, apo përdorimin nga **Përdoruesi**, të pajisjes elektrike në objektet e **Përdoruesit**.

5.5 Aranzhimet e Kyçjes

5.5.1 Tensioni i Kyçjes

- 5.5.1.1 Gjatë aplikimit për **kyçje**, **OSSH** duhet që në konsultim me **Përdoruesin**, të specifikoj nivelin e tensionit në të cilin do të **kyçet Përdoruesi** në përputhje me kushtet normale për llojin e **ngarkesës** që do të furnizohet si dhe karakteristikat e rrjetit.
- 5.5.1.2 Në përgjithësi, niveli i tensionit do të jetë minimumi i tensionit nominal në përdorimin standard në **Sistemin Shpërndarës**, (të përcaktuara në 5.5.1.3), e vlerësuar kundrejt:
- (a) operimit të kënaqshëm të instalimit
 - (b) izolimin e pengesave që vijnë nga konsumatorëve tjerë
 - (c) kostot e ciklit jetësor
 - (d) kostoja e **kyçjes**

5.5.1.3 Zhvillimet në **Sistemin e Shpërndarjes** janë duke shkuar nga regjimet më të reja dhe më efikase të tensionit. Sistemi nominal 10 kV në mënyrë progresive duhet shndërruar në 20 kV derisa sistemi 35 kV të shndërrohet në favor të sistemeve 110 kV dhe 20 kV. Për këto shkaqe:

- **Kyçjet** në 10 kV duhet të kenë mundësinë për shndërrim në 20 kV në të njëjtën kohë kur bëhet shndërrimi i rrjetit lokal; dhe
- **OSSH** duhet të këshillojë **Përdoruesit** e mundshëm potencial në kohën e aplikimit, nëse ka ndonjë plan të qëndrueshëm për të ndryshuar operimet prej 35 kV në 110 kV apo 20 kV në një datë në të ardhmen. Në raste të tilla **Përdoruesit** duhet të marrin masa për një ndryshim të tillë.

5.5.1.4 **OSSH** mundet kohë pas kohe, të specifikojë tensionin e ndryshëm prej nominales me qëllim që të shmang pengesat potenciale të shkaktuara nga aparatet e **Përdoruesit** tek **Përdoruesit** tjerë në **Sistemin e Shpërndarjes** apo për shkaqe tjera teknike, apo mund të dakordohet për metoda alternative për zvogëlimin e efekteve të ngarkesave penguese.

5.5.2 Informata që sigurohen nga OSSH

5.5.2.1 Bazuar në informatën e dhënë nga **Përdoruesi** për **kyçe** në **Sistemin Shpërndarës**, **OSSH** do të përgatis një paraqitje të gjendjes që përmban sa më shumë elemente të domosdoshme, ose relevante, për instalimin e propozuar, siç janë:

- a) Tensioni nominal në të cilin do të bëhet **kyçja**,
- b) Metoda e **kyçjes**, zgjerimit dhe (apo) detajet mbështetëse,
- c) Impedanca normale në burim tek **pika e kyçjes**,
- d) Metoda e **tokëzimit**,
- e) Kapaciteti maksimal i importimit,
- f) Kufijtë e konsumatorëve individual në lidhje me:
 - Distorzioni (Shtrembërimi) i **Harmonikëve**
 - Luhatjet e tensionit
 - Debalansi
- g) Periudha e pritjes deri në realizimin e **kyçjes** së re (pasí të pranohen zyrtarisht kushtet e **furnizimit**)

h) Kostoja e kyçjes

5.5.3 Kufijtë e Pronësisë

5.5.3.1 **Pika** apo **pikat** në të cilat është dhënë apo është marrë furnizimi i energjisë elektrike ndërmjet **Sistemit të Shpërndarjes** dhe instalimit të **Përdoruesve** duhet të dakordohet në mes të **OSSH** dhe **Përdoruesit** ashtu siç kërkohet.

5.5.3.2 Për **furnizimet** e **TU** përgjegjësia e **OSSH** zgjerohet deri tek **pika e kyçjes** së **konsumatorit** e cila normalisht është:

(a) Në shumicën e rasteve:

Tek daljet e **TMRR** dhe hyrja në ndërpresin kryesor tek **furnizimi i konsumatorit**.

b) Në objektet afariste dhe të amvisërisë në **Pikën e Kyçjes** në pjesën e pasme të njëhsorit ose në anën e **furnizimit** të ndërprerësit kryesor (siguresave kryesore).

5.5.3.3 Për furnizimet e **Tensionit të Mesëm, kufijtë e pronësisë** do t'i nënshtrohen marrëveshjes specifike ndërmjet **palëve** për secilin rast veç e veç. Ndryshimet në marrëveshjet mbi kufijtë e propozuar nga cilado **palë** duhet të arrihen paraprakisht.

5.5.3.4 Të gjitha pajisjet tek **Kufijtë e Pronësisë** duhet t'i përmbushin kriteret e dizajnit të përfshirë në Kapitullin 4 dhe 5. **Kyçjet** në hyrje dhe dalje prej **Sistemit të Shpërndarjes** duhet të inkorporojnë mjetet e ç'kyçjes së instalimit të **Përdoruesit** nga **OSSH**.

5.5.3.5 Pronësia përkatëse e stabilimentit apo aparateve duhet të regjistrohet në një **marrëveshje** të shkruar në mes **OSSH-së** dhe **Përdoruesit** apo në formë të diagramit, sipas kërkesës. Në mungesë të **marrëveshjes** së veçantë në mes **palëve** përgjegjësitë mbi ndërtimin, kontrollimin, **operimin** dhe **mirëmbajtjen**, shkojnë sipas pronësisë.

5.6 Kriteret Teknike për Kyçje

5.6.1 Standardet e kyçjes

5.6.1.1 **Kushtet e Kyçjes** përcaktojnë standardet minimale për metodën e **kyçjes** në **Sistemin e Shpërndarjes** me standardet teknike, të planifikimit dhe operative, që do të plotësojnë **Përdoruesit** që **kyçen** në **Sistemin e Shpërndarjes**. **Kushtet e Kyçjes** specifikojnë marrëveshjet teknike të kërkuara në **kufijtë e pronësisë** në mes të **Sistemit të Shpërndarjes** dhe Instalimit të **Përdoruesit** të **Sistemit të Shpërndarjes** dhe aplikimit të tij në të gjitha nivelet e tensionit të **Sistemit të Shpërndarjes**. **Kushtet e Kyçjes** përmbledhin llojet e të dhënave dhe treguesit që do të kërkohen për t'u bërë të disponueshëm për **OSSH**-në nga çdo **Përdorues** i **Sistemit të Shpërndarjes**. **Kushtet e Kyçjes** aplikohen nga të gjithë **Përdoruesit** e **Sistemit të Shpërndarjes** të **kyçur** që kërkojnë modifikimin e **kyçjes** ekzistuese, si dhe nga **Përdoruesit** që planifikojnë të **kyçen** në **Sistemin e Shpërndarjes**.

5.6.1.2 Një **kyçje** në **Sistemin Shpërndarës** mund të bëhet përmes një linje ajrore, një kabllo nëntokësor apo kombinim i të dyjave. Konfigurimi i rrjetit në **Pikën e Kyçjes** mund të merr një numër të formave të përshtatshme me natyrën e **ngarkesës** dhe aranzhimeve të rrjetit.

5.6.1.3 Të gjitha pajisjet në një instalim të kyçur në **Sistemin e Shpërndarjes** duhet të dizajnohen, prodhohen, testohen dhe instalohen në përputhje me të gjitha obligimet e zbatueshme të njohura me ligj dhe do të jenë konform standardeve relevante CENELEC, **IEC** apo Këshilli Elektro-Teknik i Kosovës që është aktual gjatë asaj kohe të **kyçjes** apo instalimit në **Sistemin e Shpërndarjes**.

5.6.1.4 Nëse në rastet specifike nuk mund të referohet në standardet vendore të aprovuara atëherë do të shfrytëzohet ndonjë standard relevant i Bashkimit Evropian, që është aktual në datën e **Marrëveshjes** së zbatueshme të **kyçjes** së **Përdoruesit**, që do të aplikohet. Nëse **OSSH** e konsideron të domosdoshme, mund t'i njoftojë **Përdoruesit** se do të pajtohet me specifikacione të plotësuara dhe standardet, me ç'rast edhe stabilimentet dhe aparatura e **Përdoruesit** duhet të përshtatet gjithashtu.

5.6.1.5 Të gjitha pajisjet në një instalim të kyçur në **Sistemin e Shpërndarjes** duhet të jenë të përshtatshme për përdorim në frekuencën operative të **Sistemit të Shpërndarjes** dhe në vlerat nominale të tensionit dhe **rrymës së lidhjes së shkurtë të Sistemit të Shpërndarjes** siç është treguar në 5.6.5.1, në **Pikën e Kyçjes**. **OSSH** mund të kërkojë certifikimin se pajisjet janë të dizajnuara dhe instaluar në një mënyrë të kënaqshme. **OSSH** gjithashtu mund të kërkojë dëshmi se pajisjet janë testuar për t'u përshtatur me standardet **IEC**.

5.6.1.6 Për **Përdoruesit** e kyçur në **Tensionin e Ulët**, instalimet duhet të jenë në përputhje me Standardet Kombëtare për Instalimet Elektrike dhe ndonjë rregull dhe rregullativat e lëshuara nga RrKEI kohë pas kohe. **Përdoruesve** të cilët veprojnë në përputhje me këto rregulla dhe rregullativa do të u kërkohej që të jenë në përputhje me kërkesat e **Kodit të Shpërndarjes** sa i përket dizajnit dhe aspektit të sigurisë. **OSSH** mund të kërkojë dëshmi për testimin e pajisjeve për t'u përputhur me standardet relevante.

5.6.1.7 Para hyrjes në **marrëveshje për kyçje** do të jetë e domosdoshme për **OSSH** që të jetë arsyeshmërisht e kënaqur që sistemi i **Përdoruesit** në kufirin me **Sistemin e Shpërndarjes** duhet të jetë në përputhje me kërkesat e përshtatshme të **Kodit të Shpërndarjes**.

5.6.2 Kërkesat e Mbrojtjes

5.6.2.1 **Përdoruesit** duhet të sigurojnë që defektet në stabilimentin dhe aparatet e **Përdoruesit** mos të shkaktojnë pengesa të pa arsyeshme në **Sistemin e Shpërndarjes** apo tek **Përdoruesit** tjerë. Pa e kufizuar këtë obligim, një **Përdorues** duhet që para **kyçjes** së instalimit të **Përdoruesit** në **Sistemin e Shpërndarjes**, të instalojë pajisjen mbrojtëse.

5.6.2.2 Rëniet në **Sistemin e Shpërndarjes** mund të shkaktojnë dëme në stabilimentin dhe aparatet e **Përdoruesit**. Këto rënie mund të rezultojnë me humbjen e fazës, mbitensionet apo nëntensionet dhe mund të dëmtojnë si prodhuesit ashtu edhe shfrytëzuesit e **Sistemit të Shpërndarjes**. **Përdoruesit** duhet të marrin parasysh praktikat e themeluara të ndonjë rrjeti të veçantë në të cilin do të bëhet **kyçja** dhe të

sigurojë që mbrojtja e instaluar do të jetë në përputhje me atë të përdorur nga **OSSH**. Përshtatshmëria e mbrojtjes së instaluar nga **Përdoruesi** është përgjegjësi e **Përdoruesit**.

5.6.2.3 Aranzhimet e mbrojtjes së **Përdoruesit** në **Kufijtë e Pronësisë**, duke përfshirë llojet e pajisjes dhe të mbrojtjes, duhet të jenë kompatible me kushtet e sistemit ekzistues dhe praktikën e mbrojtjes së **Sistemit të Shpërndarjes** siç është specifikuar nga **OSSH** gjatë kohës së aplikimit. Në veçanti:

- (a) Kohët maksimale të periudhës (prej fillimit të prishjes deri tek shuarja e harkut) duhet të jetë brenda kufijve të përcaktuar nga **OSSH** në përputhje me standardet e vlerësimit të **rrymave të lidhjeve të shkurta** për mbrojtjen dhe pajisjet të adaptuara për **Sistemin e Shpërndarjes**;
- (b) Në **kyçjen** me **Sistemin e Shpërndarjes**, **Përdoruesi** do të jetë i vetëdijshëm se rikyçja automatike e shpejtë dhe e ngadaltë është një veçori e operimit të sistemit Elektroenergjetikë. Kjo karakterizohet përmes de/ri-energizimeve të papritshme të furnizimit me energji elektrike. Kohët pa tension zakonisht janë 3s dhe 60s në **Tensionet e Mesme**; dhe
- (c) **Përdoruesit** gjithashtu do të jenë të vetëdijshëm se ç'kyçja e vetëm një apo dy fazave të një sistemi tre fazor mund të afektohet prej aranzhimeve të **mbrojtjes** së Shpërndarjes për lloje të caktuara të defekteve.

5.6.2.4 **Mbrojtja** minimale e kërkuar për instalimin e kyçur të **Përdoruesit** në **Sistemin e Shpërndarjes** do të ndryshojë sipas llojit, madhësisë, metodës së kyçjes (si p.sh. lidhja bistekore e kablove) dhe tokëzimi i sistemit të **Përdoruesit**.

Konsumatorët e Tensionit të Ulët duhet të jenë në përputhje me Kapitullin 6 të **Sistemit të Shpërndarjes** dhe praktikës shtetërore për **kyçjen** e konsumatorëve. Nëse instalimet e **Përdoruesve** tjerë do të ndryshojnë, është parashikuar se **kyçja** e re mund të kërkojë të gjitha apo disa prej pajisjeve mbrojtëse në vazhdim:

- (a) Mbrojtjen mbirrymore dhe mbingarkesës;
- (b) **Mbrojtjen** nga lidhja e shkurtë me tokë (e përshtatshme për sistemin e furnizimit lokal);
- (c) Diferenciale;

(d) Të tjera.

5.6.2.5 Në vendin e ndërlidhjes ku përdoren ndërprerës të qarkut ata duhet të instalohen me tipe të releve të pranueshëm nga **OSSH**. Këta rele do të kenë elemente mbirrymore dhe mbingarkesë tre fazore dhe një element për lidhjen e shkurtë me tokë. Këto rele do të kenë karakteristikën kohë-rrymë që përputhen me tipet e standardeve A, B dhe C të **IEC 255**.

Parametrat maksimal të pranueshëm për rele në kufijtë e pronësisë, e që janë të domosdoshme për të siguruar selektivitetin me pajisjet e shpërndarjes, do të sigurohen nga **OSSH**, dhe këta parametra mund të rishqyrtohen nga **OSSH** në çdo kohë në të ardhmen. Mbrojtja e **Sistemit të Shpërndarjes** synon të zvogëlojë ndikimin e rënieve përfshirë kohëzgjatjen e uljes së tensionit dhe nuk duhet të ketë ndikim të kundërt nga kufizimet e mbrojtjes së **përdoruesve**.

- (a) Në mënyrë që të sigurohet operim i kënaqshëm i **Sistemit të Shpërndarjes**, sistemet e mbrojtjes, kohët e operimit, selektiviteti, dhe ndjeshmëria në **kufirin e pronësisë**, do të dakordohen në mes **OSSH-së** dhe **Përdoruesit** gjatë aplikimit për procesin e **kyçjes**, dhe mund të rishqyrtohet herë pas herë nga **OSSH**;
- (b) Në mënyrë që të mbulohet një ndërprerës i qarkut, apo pajisjes që ka funksion të ngjashëm, e cila dështon për të operuar në mënyrë korrekte për ndërprerjen e rrymave të prishjes në sistem, mbrojtja ndihmëse përmes operimit të ndërprerësve tjerë të qarkut apo pajisjeve që kanë funksion të njëjtë duhet normalisht të sigurohet; dhe
- (c) Përveç nëse **OSSH** këshillon ndryshe, nuk është e pranueshme për **Përdoruesit** të kufizojnë rrymat furnizuese të prishjes në **Sistemin e Shpërndarjes** përmes përdorimit të **mbrojtjes** dhe pajisjeve shoqëruese për kufizimin e rrymave të prishjeve ashtu që defektet në atë pajisje **mbrojtëse** apo shoqëruese, me rastin e shfaqjes së prishjeve veprimi i **mbrojtjeve** në pronësi të **OSSH-së** të operojë jashtë kategorisë së vet nominale të **lidhjeve të shkurtra**.

5.6.2.6 Reletë **mbrojtëse** duhet të komisionohen në vendndodhje nga **Përdoruesi** i cili do të sigurojë që parametrat të jenë nën nivelet maksimale të lejuara. Në raste të caktuara **OSSH** mund të kërkojë që të jetë prezent gjatë testimit të tyre dhe do të jetë

përgjegjësi e **Përdoruesit** për të siguruar që paralajmërimi i mjaftueshëm i është dhënë **OSSH** për raste të tilla. **Përdoruesit** do të sigurojnë që parametrat e **mbrojtjeve** të mbesin nën nivelet maksimale të lejuara. Kjo mund të kërkojë testime të rregullta të këtyre releve.

5.6.3 Tokëzimi

5.6.3.1 **Tokëzimi** i pjesës së instalimit të **Përdoruesit** i cili është i kyçur në **Sistemin e Shpërndarjes** do të jetë në pajtim me kërkesat si në këtë Kapitull.

5.6.3.2 Aranzhimet për **kyçjen** e instalimit të **Përdoruesit** me tokë do të dizajnohen ashtu që të jenë konform me standardet relevante ndërkombëtare.

5.6.3.3 Metoda e tokëzimit të **Sistemit të Shpërndarjes** varësisht nëse lidhja është direkte me tokë apo përmes ndonjë impedanse (rezistence) duhet të përcaktohet nga **OSSH**. Specifikacioni i pajisjes së ndërlidhur do të përmbush vlerat e tensionit i cili do të veproj në pajisjet si rezultat i metodës së tokëzimit.

5.6.3.4 **Përdoruesit** do të marrin masa paraprake për të kufizuar dukuritë dhe efektet e rrymave qarkulluese në respekt me pikat neutrale të kyçura me **tokëzim** aty ku ka më shumë se një burim të furnizimit të energjisë.

5.6.4 Rregullimi i Tensionit dhe Kontrollimi

5.6.4.1 Zgjerimet apo **kyçjet** në **Sistemin e Shpërndarjes** duhet të dizajnohen në atë mënyrë që të mos pengojnë kontrollimin e domosdoshëm të tensionit në **Sistemin e Shpërndarjes**. Informata për rregullimin e tensionit dhe aranzhimet e kontrollimit duhet të vihen në dispozicion nga **OSSH** nëse një gjë e tillë kërkohet nga **Përdoruesi**.

5.6.5 Nivelet e Lidhjeve të shkurtra

5.6.5.1 Vlera nominale e **lidhjes së shkurtë** të pajisjeve të **Përdoruesit** në **pikën e kyçjes** nuk duhet të jetë më e vogël se kufiri i lejuar e definuar sipas **Sistemit të Shpërndarjes** siç është treguar në tabelën vijuese. Zgjedhja e pajisjes për **kyçje** në

Tensionin e Ulët mund të merr parasysh rëniet e tensionit në linjat e sistemit të shpërndarjes. **OSSH** duhet të marrë parasysh kontributin në nivelin e defektit të sistemit të kyçur të **Përdoruesit** dhe aparaturave të tij në dizajnin e sistemit të tij.

Tensioni në kyçe	Niveli i Lidhjeve të shkurtra (RMS Simetrike) Normalisht	Niveli i Lidhjeve të Shkurtra (RMS Simetrike) Disa Pjesë të Përcaktuara
TU (Shtëpiak)	9.0 kA	
TU (Ind/Kom)	37.0kA	
6.3kV	31,5 kA	40 kA
10 kV	31,5 kA	40 kA
20 kV	31,5kA	40 kA
35 kV	31,5 kA	40 kA

Në disa trafostacione 220/35 kV në zbarrat e 35 kV niveli i dizajnuar i **lidhjes së shkurtë** është 40 kA.

5.6.5.2 Furnizimi në hyrje i **Përdoruesit** duhet të kontrollohet përmes një ndërprerësi kryesor i cili duhet të jetë në përputhje me standardin e njohur ndërkombëtar të pranueshëm për **OSSH**.

5.6.6 Nivelet e Izolimit

5.6.6.1 Dizajni i një pajisjeje të operuesit të **kyçur** në **Sistemin e Shpërndarjes** duhet të jetë i atillë që të mundësojë përballimin e tensionit (gjatë testimit) për **rrymat alternative AC** dhe tensionet e impulsit (1.2/50 μ S) të paraqitur në tabelën në vijim.

Tensioni i Pajisjes	Niveli përballues AC	Niveli i impulsit
TU	3 kV	
6.3kV	20 kV	40 kV

10kV	28kV	75 kV
20kV	50 kV	125 kV
35KV	70 KV	170 kV

5.6.7 Efektet Kapacitive dhe Induktive

5.6.7.1 **Përdoruesi** (kur aplikon për të bërë kyçjen) duhet të sigurojë për **OSSH** informatat ashtu siç është detajizuar në standardet e dizajnit. Duhet të kërkohen detajet e çdo kompensatori dhe reaktanse (rezistori) të **kyçur** në **Tensionin e Mesëm**, të cilët do të mund të kenë ndikim në **Sistemin e Shpërndarjes** dhe të cilët janë propozuar të **kyçen** nëse janë dakorduar me **OSSH**-në. Kur kërkohen nga **OSSH**, detajet duhet poashtu të sigurohet për shpërndarjen e kapacitansës dhe induktansës së qarkut. Detajet e mjaftueshme kërkohen për:

- (a) të verifikuar se pajisja kontrolluese e **Sistemit të Shpërndarjes** është e vlerësuar në mënyrë të përshtatshme;
- (b) të tregohet se performanca e **Sistemit të Shpërndarjes** nuk do të dobësohet dhe
- (c) të sigurohet që bobinat për shuarjen e rrymës capacitive në neutrin e **Sistemit të Shpërndarjes** të jenë të instaluara dhe të përdorura për operim në mënyrë të saktë.

5.6.8 Ç'rregullimet e Tensionit

5.6.8.1 **Përdoruesit e Sistemit të Shpërndarjes** nuk duhet të krijojnë pengesa të tensionit në nivel që do të ndikonte tek **Përdoruesit** e tjerë. **Përdoruesit** për interes të tyre duhet të zgjedhin pajisjen e cila është në gjendje të funksionojë kënaqshëm në prani të pengesave deri në nivelet e lejuara nga EN50160.

5.6.8.2 Është kusht i **kyçjes** që pajisja e kyçur në **Sistemin e Shpërndarjes** duhet të jetë konform me kërkesat e Direktivës së KE 89/336/EEC (Direktiva EMC) pas përmirësimit.

5.6.8.3 Ngarkesat dhe instalimet do të pajtohen me kufijtë e emërtuar në vazhdim:

(a) Dridhja e Tensionit

i) Frekuenca e paraqitjes: (0.22 – 600) për min

Niveli i Tensionit	P _{st}	Pl _t
TM,TU	1.0 njësi	0.8 njësi

P_{st}: Ashpërsia e Dridhjeve Afat Shkurtër – një indeks i ashpërsisë vizuale i vlerësuar përgjatë një periudhe prej 10 minutash.

Pl_t: Ashpërsia e Dridhjeve Afat Gjata – një indeks i ashpërsisë vizuale të vlerësuar gjatë një periudhe prej 2 orësh.

ii) **Frekuenca** e dukurisë: (0.02 – 0.22) për min
Amplituda deri në 3% është e lejuar.

iii) **Frekuenca** e dukurisë: ≤ 0.02 për min
Amplituda deri në 5% është e lejuar.

(b) Shtrembërimi i Harmonikëve

(i) Rregulli individual i **Harmonikëve**:

% Distorzioni i Tensionit të **Harmonikëve**

(tensioni rms si një % e vlerës rms të komponentës fundamentale)

Nr. Rendor i harmonikut:	TU	TM
2	0.70	0.50
3	0.75	0.50
4	0.70	0.50
5	2.00	1.00

6	0.50	0.50
7	2.00	1.00
8	0.50	0.50
9	0.50	0.50
10	0.50	0.75
11	1.50	1.50
12	0.50	0.50
13	1.50	1.50
14	0.50	0.50
15	0.50	0.75
16	0.75	0.75
17	0.75	0.75
18	0.50	0.50
19	1.00	0.50

rms – vlera efektive

ii) Distorzioni total i **Harmonikëve**

Niveli i Tensionit	% Distorzioni i Tensionit të Harmonikëve
TU	2.5
TM	2.0

(c) Ç'ekuilibrimi

Ç'ekuilibrimi i shkaktuar nga **kyçja** e një instalimi individual nuk do të kalojë 2 % në pikën e **kyçjes** së përbashkët.

5.6.8.4 Nën kushte të prishjes dhe veprimeve në rrjet komponenta e **frekuencës** së kategorizuar të tensionit mund të bie apo ngritët përkohësisht. Ngritja apo rënia në tension do të ndikohet nga metoda e tokëzimit të pikës neutrale të **Sistemit të Shpërndarjes** dhe tensioni mund të bie përkohësisht në zero në të gjitha pikat e rënies.

Seksioni 2 dhe 3 i EN 50160, pas përmirësimit kohë pas kohe përmban detaje shtesë të ndryshimeve dhe pengesave në tension të cilat do të merren parasysh në zgjedhjen e pajisjes prej specifikimeve të duhura për instalim apo **kyçje** në sistem.

5.6.9 Faktori i Fuqisë dhe Ekuilibrimi i Fazës

5.6.9.1 **Konsumatori** do të ndërmerr hapa të arsyeshëm për të operuar stabilimentin dhe pajisjen për të mbajtur **faktorin e fuqisë** të ngarkesës totale në pikën e **kyçjes** për energjinë elektrike të importuar në mes të 0.95 dhe 1 (njëshit) dhe energjinë elektrike të eksportuar në mes 0.95 dhe 1 (njëshit). **Gjeneratorët** me erë duhet të mbajnë **faktorin e fuqisë** në mes 0.92 dhe 0.95 në krahasim me 1 (njëshin). Për qëllimin e këtij **Kodi**, **faktori i fuqisë** i referohet përvetësimit të **fuqisë reaktive**. Këto janë kërkesa minimale. Në raste të caktuara mund të aplikohen kërkesa specifike në mënyrë që të sigurohet që **OSSH** të mund të veprojnë në përputhje me kërkesat e **Kodit të Rrjetit**.

5.6.9.2 Kërkesat e **OSSH** për ekuilibrimin e fazës janë mbuluar në standardin EN50160.

5.7 Matja /Telematja

5.7.1 Nga **Përdoruesi** mund të kërkohej që të sigurojë impulse të tilla të tensionit, rrymës, **frekuencës**, **Fuqisë Aktive** dhe **Reaktive** të cilat konsiderohen të domosdoshme nga **OSSH** për të siguruar monitorimin adekuat të sistemit. Detajet do të specifikohen në **Marrëveshjen për Kyçje të Përdoruesit**.

5.7.2 **Njësitë Gjeneruese** që dispeçohen nga **Qendra Nacionale Dispeçerike**, do të sigurojnë sinjale për **OST**-në ashtu siç kërkohej nga **Kodi i Rrjetit**.

5.7.3 Nëse është arritur **marrëveshje** në mes **palëve** ashtu që **OSSH** do të kontrollojë ndërprerësit në sistemin e **Përdoruesit**, **OSSH** do të instalojë një stacion të jashtëm të domosdoshëm për telekontrollim. Pa marrë parasysh nga kjo që u tha më sipër, do të jetë përgjegjësi e **Përdoruesit** që të sigurojë ndërlidhjet kontrolluese të domosdoshëm për ndërprerësit e **Përdoruesit** që duhet të kontrollohen.

5.7.4 Parimet e matjes që aplikohen te **Përdorues** të caktuar të **kyçur** në **Sistemin e Shpërndarjes** janë specifikuar në **Kodin e Matjes**.

5.7.5 Aranzhimet specifike të matjes varen nga lloji i ngarkesës, madhësia dhe natyra e instalimeve që janë kyçur.

5.7.6 Personeli i cili kryen dizajnin apo punët instaluese për **përdoruesin**/ndërlidhjen e operatorit me **OSSH**-në duhet të familjarizojë vetë veten me këtë **Kod** dhe të punoj në bazë të tij. Situata të pazakonshme mund të paraqiten të cilat nuk janë të mbuluara me këtë **Kod**. Në rrethana të tilla **OSSH** do të jetë e gatshme të merret me kërkesat dhe pyetjet.

5.8 Aranzhimet Specifike

5.8.1 Aranzhimet specifike për **kyçje**, duke përfshirë kërkesat për planifikimin e trafostacionit, pajisjet e **Përdoruesit**, tarifat dhe matjet janë caktuar qartë në një numër të dokumenteve të paraqitura më poshtë (a, b dhe c). **Përdoruesit** duhet të pajtohen me kërkesat e dokumenteve relevante në instalimet e tyre.

(a) “**Kushtet për Kyçje në Sistemin e Shpërndarjes**” dhe “**Kushtet e përgjithshme për Kyçjen e Konsumatorëve Industrial, Komercial dhe Gjeneratorëve në Sistemin e Shpërndarjes**”;

(b) Kushtet të cilat drejtojnë **kyçjen** në **Sistemin e Shpërndarjes: Kyçjet** në 35 kV, 20 kV, 10 kV, 6.3kV dhe **Gjeneratorët** e pavarur në TU, 6.3 kV, 10 kV, 20 kV dhe 35 kV;

(c) Specifikimi i përgjithshëm për objektin e trafostacionit të **tensioneve të mesme (TM)**.

5.8.2 **Furnizimet** në tensionin e ulët (230V/400V) janë të zakonshme. Standardet e shërbimit në lidhje me **furnizime** të tilla janë të përcaktuara si në vijim:

(a) Skema e lidhjes në **Sistemin e Shpërndarjes**

Rregullat për furnizimet e **tensionit të ulët** janë (duhet) publikuar më detajisht në tri dokumentet tjera:

- (b) “Metodologjia e Tarifave për Kyçje” në **Sistemin e Shpërndarjes** dhe “Rregullin për Kushtet e Përgjithshme për furnizimin me Energji Elektrike të Konsumatorëve Industrial, Komercial dhe **Gjeneratorëve** në **Sistemin e Shpërndarjes**”;
- (c) **Furnizimi** shtëpiak: Procedurat dhe kushtet për **furnizimin** e një objekti të ri prej **Sistemit të Shpërndarjes**.
- (d) **Furnizimi** shtëpiak: Specifikimi i kushteve për **furnizim** deri tek **pika matëse**.

Duhet pasur parasysh se të gjitha dokumentet që i referohen 5.8 i nënshtrohen freskimit dhe ndryshimit. Në kohën e ndonjë **kyçje** të propozuar, duhet të përdoren vetëm versionet e fundit të këtyre dokumenteve.

Kapitulli VI

6 Operimi i Sistemit të Shpërndarjes

6.1 Pjesa e përgjithshme

6.1.1 Hyrje

6.1.1.1 Në mënyrë që **OSSH** të operojë me **Sistemin e Shpërndarjes** në mënyrë efektive dhe të sigurojë sigurinë maksimale dhe stabilitetin e sistemit, ekziston një nevojë për ata **përdorues** të specifikuar në 6.1.1.6 që të paraqesin informata për ngarkesën dhe **gjenerimin** e **kyçur** në **OSSH**.

6.1.1.2 **Kodi i shpërndarjes** specifikon informatat që duhet të parashtrihen për **OSSH**-në nga **Përdoruesit** e tjerë të **Sistemit të Shpërndarjes** ashtu që këto kërkesa të mund të plotësohen.

6.1.1.3 Informatat që duhet të paraqiten duke u bazuar në operimin e **Sistemit të Shpërndarjes** kërkohet që t'i mundësojë **OSSH**-së të mirëmbajë funksionimin e **Sistemit të Shpërndarjes**.

6.1.1.4 Kur të dhënat kërkohen nga **Përdoruesi**, kjo nënkupton **kërkesën** për energji elektrike në **Pikën e Kyçjes**. **OSSH** në disa raste mund të specifikon që të dhënat e kërkuara duhet të përfshijnë kërkesën për MVAR.

6.1.1.5 Mënyrat e paraqitjes së informatave tek **OSSH** dhe konfirmimin e saj përfshinë çdo lloj forme të shkruar (jo-kalimtare), ose çdo lloj transferi të paraqitur në mënyrë elektronike që mundëson pranuesin të mbajë informatat.

6.1.1.6 Objektivat e operimit të **Sistemit të Shpërndarjes** janë:

- Të paraqes parashikimin e ngarkesës dhe informatat që dalin nga stabilimenti **gjenerues** që duhet të sigurohen nga **Përdoruesit** ashtu që të mundësojë **OSSH** të operon me **Sistemin e Shpërndarjes**.
- Të specifikojë informatat që duhet të paraqiten nga **Përdoruesit** tek **OSSH** që të mundësojë përshtatshmërinë me obligimet e marra nga **Kodi i Rrjetit**.

6.1.1.7 Përdoruesit e Sistemit të Shpërndarjes që kanë këtë fushëveprim janë:

- **Konsumatorët e privilegjuar** të kyçur në **Sistemin e Shpërndarjes**,
- **Konsumatorët e Tensionit të Mesëm** për të cilët **OSSH** mendon se është e domosdoshme, dhe,
- **Gjeneratorët** e pavarur me **njësi të Gjenerimit** mbi 2 MW.

6.1.2 Rrjedhja e Informatave dhe Ko-ordinimi

6.1.2.1 **OSSH** do të koordinoj informatat për parashikimin e **ngarkesës** për çdo **pikë furnizuese** të madhe që të plotësoj kërkesat e parashtruara me **Kodin e Rrjetit**. **OSSH** do të grumbulloj informatat mbi parashikimin e paraqitur nga **Përdoruesit**, kur është e përshtatshme dhe do t'i paraqes informatat mbi parashikimin tek **OST** ku **ngarkesa** ose ndryshimi, është më i madh se 10 MW në çdo **pikë të lidhjes**. (duhet të jetë në përputhshmëri me **Kodin e Rrjetit**).

6.1.2.2 Informatat mbi **Gjeneratorët** e pavarur të kyçur në **Sistemin e Shpërndarjes** të cilët nuk i nënshtrohet **QND**, duhet të paraqitet tek **OSSH**, aty ku është e specifikuar. **Përdoruesit e Privilegjuar** dhe **Konsumatorët me Vet-Prodhim** duhet gjithashtu t'u kërkohej që t'i dorëzojnë informatat.

6.1.2.3 Njësitë e **Gjenerimit** që i përgjigjen **QND** duhet të përshtaten me kërkesat e **Kodit të Rrjetit**. Informatat duhet të dorëzohen drejtë për së drejti te **OST**

6.1.3 Të Dhënat mbi Parashikimin e Ngarkesës

6.1.3.1 **Njësitë e Gjenerimit** më të mëdha se 2 MW dhe që nuk i nënshtrohen **QND** duhet të paraqesin tek **OSSH** informatat mbi daljet dhe planifikimin e ndërprerjeve për periudhat e ardhshme të specifikuar kohore. Kjo do të paraqitet në baza vjetore atëherë kur kërkohej nga **OSSH**. Informatat e kërkuara janë dhënë në Regjistrin e të Dhënave Teknike (RDhT).

6.1.3.2 **Konsumatorët e privilegjuar** duhet të paraqesin tek **OSSH** informatat mbi **ngarkesën** dhe planifikimin e ndërprerjeve minimum 30 ditë paraprakisht. Kjo do të

paraqitet në baza vjetore atëherë kur kërkohet nga **OSSH**. Informatat e kërkuara janë dhënë në Regjistrin e të Dhënave Teknike (RDhT).

6.1.4 Humbja e Qendrës së Kontrollit

6.1.4.1 Qendra e kontrollit të **OSSH** luan një rol thelbësor për t'i siguruar **OSSH** aftësinë që të vë në funksionim sistemin energjetik të shpërndarjes në nivelet e kërkuara të sigurisë dhe besueshmërisë. Në rastet kur **qendra e kontrollit të OSSH** bëhet e papërdorshme për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme, atëherë duhet të vihet në dispozicion një plan krize i **qendrës së kontrollit** për transferimin e qetë të funksioneve të qendrës së kontrollit ashtu që do të lehtësonte funksionimin e vazhduar, të sigurtë dhe duke kontrolluar gjithë **Sistemin e Shpërndarjes** të Kosovës.

6.1.4.2 Plani i Krizës së **qendrës së kontrollit** do të përgatitet nga **OSSH** dhe do të përfshijë minimumin si në vijim:

- Detajet e metodave të komunikimit të emergjencës për të dakorduar transferimin e funksioneve të qendrës së kontrollit;
- Një listë kontrolluese të masave që do të ndërmerren dhe nga kush do të ndërmerren;
- Aranzhmanet e detajuara për transferimin e funksioneve të kontrollit.

6.1.4.3 Plani i krizës së **qendrës së kontrollit** duhet të testohet plotësisht ose pjesërisht në baza të rregullta të paktën një herë në dy vjet për të siguruar që ai është i zbatueshëm dhe se informacioni i nevojshëm është në dispozicion në lokacionet korrekte dhe personeli është plotësisht i trajnuar për ta kryer atë.

6.2 Koordinimi i ndërprerjeve të planifikuara

6.2.1 Qëllimi dhe Objektivat e Koordinimit të Ndërprerjeve të Planifikuara

6.2.1.1 Operimi i **Sistemit të Shpërndarjes** ko-ordinon **Ndërprerjet e Planifikuara** të stabilimenteve dhe pajisjeve të cilat ndikojnë në operimin e **Sistemit të Shpërndarjes**.

6.2.1.2 **OSSH** plotëson obligimet që dalin nga **Kodi i Shpërndarjes** për sigurimin e informatave të caktuara për **OST**, në bazë të **Kodit të Rrjetit** dhe themelon procedura që mundësojnë grumbullimin e të dhënave specifike të **Përdoruesve**.

6.2.1.3 Mënyrat e sigurimit të informatave tek **OSSH** dhe konfirmimi i tyre përfshinë çdo formë të rregullt të shkruar, ose çdo formë tjetër të mundshme në formë elektronike që i mundëson pranuesit që të ruaj informatën.

6.2.1.4 Në mënyrë që **OSSH** t'i plotësoj këto kërkesa të operimit të **Sistemit të Shpërndarjes** duhet që të bëhet e njohur se informata e caktuar në **Kodin e Rrjetit** e cila do të sigurohet nga **OST**, do të jetë bazë e planit operues të **Sistemit të Shpërndarjes**.

6.2.1.5 Objektivat e operimit të **Sistemit të Shpërndarjes** janë:

- Cakton procedurat e planit operues dhe orarin kohor të përshtatshëm për koordinimin e ndërprerjeve të **ngarkesave** për stabilimente dhe pajisje të paraqitura nga **Përdoruesi**, ashtu që i mundëson **OSSH** të operoj me **Sistemin e Shpërndarjes**.
- Specifikon informatat që paraqiten nga ana e **Përdoruesit** tek **OSSH** në përputhshmëri me **Kodin e Shpërndarjes**.

6.2.1.6 Koordinimi i planifikimit të ndërprerjeve aplikohet për këta **Përdorues** të **Sistemit të Shpërndarjes**:

- **Konsumatorët e Privilegjuar të kyçur** në **Sistemin e Shpërndarjes**,
- **Konsumatorët e Tensionit të Mesëm** për të cilët **OSSH** konsideron se është e domosdoshme;
- Stabilimentet e **Gjeneratorëve** të pavarur që nuk janë subjekt i **QND**; dhe
- **Konsumatorët e Privilegjuar dhe Vet-Prodhuës**.

6.2.2 Përgatitja e Informatave

6.2.2.1 Informatat për Stabilimentet e **Gjeneratorëve** të pavarur që nuk janë subjekt i **QND** (përfshirë **Konsumatorët e Privilegjuar** dhe **Konsumatorët Vet-Prodhuës**) duhet të dërgohen në **OSSH**, ashtu siç është e specifikuar në Planifikimin e **Sistemit të Shpërndarjes** 4.3.1(a) dhe 3(b).

6.2.2.2 Informacionet nga **Njësitë e Gjenerimit** të menaxhuara nga **Qendra Nacionale Dispeçerike** duhet të paraqiten në OST dhe të jenë në përputhje me kriteret e **Kodit të Rrjetit**.

6.2.3 Orari Kohor dhe të Dhënat

6.2.3.1 Të dhënat e grumbulluara dhe orari kohor i implementuar duhet të përcaktohet nga **OSSH** dhe nga çdo **Përdorues** tjetër. Miratimi i arsyeshëm për nivelin e tensionit, kapacitetin e Stabilimenteve dhe pajisjeve duhet të jepet nga **OSSH** kur paraqitet **kërkesa** për vlerësimin e informatave.

6.2.3.2 Informatat mund të kërkohen për periudha të ndryshme kohore ashtu siç janë përcaktuar sipas nevojave të planifikuara të **OST** ose **OSSH**.

6.2.4 Informata mbi Gjeneratorët e pavarur

6.2.4.1 Informatat nga Stabilimentet e **Gjeneratorëve** të pavarur me fuqi më të madhe se 2 MW dhe që nuk janë subjekt i **Qendrës Nacionale Dispeçerike (QND)** duhet të përmbajë ndërprerjet detale të planifikuara për mirëmbajtje ose për qëllime të tjera si dhe kohën kur pritet që të filloj punën.

6.2.4.2 **Gjeneratori** nuk do të sinkronizohet pa e marrë lejen nga **OSSH** nëse nuk është arritë **marrëveshja** me **OSSH** më parë.

6.2.5 Informatat për Përdoruesit

6.2.5.1 **OSSH** do t'i informoj **Konsumatorët e privilegjuar** ose **Gjeneratorët** që posaçërisht mund të ndikohen nga ndërprerja e caktuar e Stabilimenteve të Shpërndarjes dhe pajisjeve, për datën e mundshme të ndërprerjes dhe kohë zgjatjen e saj. Në rast të ankesave nga ana e **Përdoruesve** këto ankesa duhet të mirren parasysh dhe të propozohen konsultime alternativ.

6.3 Menaxhimi i ngarkesave për raste të veçanta

6.3.1 Qëllimi i Menaxhimit të Ngarkesave për Rastet e Veçanta

6.3.1.1 Menaxhimi i **ngarkesave** të rasteve të veçanta i operimit të Shpërndarjes ka të bëjë me përgatitjet që duhet të bëhen nga **OSSH** ose **Përdoruesit e Sistemit të Shpërndarjes**, që të lejoj zvogëlimin e **ngarkesës** në raste të veçanta, në rast të sasisë jo të mjaftueshme të energjisë elektrike në dispozicion të dhënë nga Stabilimentet e **Gjenerimit** ose të transferit nga interkoneksioni i jashtëm për të mbuluar **ngarkesën** që të mënjanohet ndërprerja e **konsumatorëve**, në rast të ndërprerjes (rënies) dhe (ose) problemeve të tjera (si p.sh. duke marrë parasysh **Frekuencën** e sistemit, nivelin e **tensionit** të sistemit ose mbingarkesat termike) në çdo pjesë të **Sistemit të Transmisionit** ose të **Shpërndarjes**.

6.3.1.2 Procedurat e kontrollës së **ngarkesës** sigurojnë që problemet për **Përdoruesit** dhe **konsumatorët** të minimizohen dhe të gjithë ata që kanë qenë të prekur nga ky problem të trajtohen njëjtë.

6.3.1.3 Menaxhimi i **ngarkesave** të rasteve të veçanta merret me këto metoda për të zvogëluar **ngarkesën**:

- (a) Ndërprerja automatike e **ngarkesës** për **frekuenca** dhe **tension të ulët**;
- (b) Reduktimi i **ngarkesës** së **konsumatorit** duke përfshirë reduktimin e **tensionit**;
- (c) Menaxhimi i **ngarkesës** së **konsumatorit** e iniciuar nga **Furnizuesit** ose grupet tjera, përveç atyre që vijnë nga instruksionet e **OST** dhe **OSSH**;
- (d) Reduktimi i **ngarkesës** së **konsumatorit** me instruksione të marra nga **OST** ose **OSSH**; dhe
- (e) Manuali i emergjencës për ç'kyçje.

Termi, kontrollimi i **ngarkesës** është përdorur që të përshkruaj çdo ose të gjitha metodat për të arritur reduktimin e **ngarkesës**.

6.3.1.4 Kur kontrollimi i **ngarkesës** është duke u zbatuar nga **OSSH**, duhet të bëhet në atë mënyrë që praktikisht sa më shumë që është e mundur të mos bëjë kurrfarë diskriminimi kundrejt asnjë **konsumatori** ose **furnizuesi** dhe duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme ashtu që ndarja të bëhet në mënyrë korrekte në mes të **konsumatorëve**. Mund të ketë raste të veçanta për **konsumatorët** vital (spitalet, shërbimet emergjente, objektet strategjike etj) dhe ata me prioritet.

6.3.1.5 Objektivat e menaxhimit të ngarkesave për raste të veçanta janë që të themelohen procedurat që mundësojnë **OSSH**-së, duke zbatuar instruksionet e marra nga **OST** ose për arritjen e reduktimit të kërkesës që do të largoj ose të lehtësoj problemet e operimit në **Sistemin e Transmisionit** dhe (ose) të **Sistemit të Shpërndarjes**, në përgjithësi ose pjesërisht në atë mënyrë që të mos bëjë pa drejtësisht diskriminim ose të preferoj ndonjë grup të **furnizueseve** ose **konsumatorëve** e vetë në përputhshmëri me **Licencën e Operatorit të Shpërndarjes**.

6.3.1.6 Menaxhimi i ngarkesave për rastet e veçanta zbatohet nga **OSSH** dhe të gjithë **Përdoruesit e Sistemit të Shpërndarjes**.

6.3.1.7 Implementimi i kontrollimit të **ngarkesës** nga **OSSH** mund të ketë ndikim për të gjithë **konsumatorët** dhe **furnizuesit** që janë të **kyçur** në **Sistemin e Shpërndarjes** dhe aty ku zbatohet **marrëveshja** në mes të **furnizueseve** dhe **konsumatorëve** të tyre duhet që të bazohet në këtë.

6.3.2 Metodatat e Kontrollimit të Ngarkesës

6.3.2.1 Furnizimi i konsumatorëve mund të ç'kyçet automatikisht në lokacione të zgjedhura në përputhje me kërkesat e **Kodit të Rrjetit**, me rastin e uljes së papritur të **frequencës**. Një veprim i tillë duhet të koordinohet me kujdes si pjesë e skemës së përgjithshme dhe duhet të llogaritet në çdo **ngarkesë** të operimit ose të **ngarkesës** esenciale.

- 6.3.2.2 Ndërprerja automatike nga reletë e nën tensionit, mund të përdoret që të ndërpritet **ngarkesa** në mënyrë të dhunshme në nivelin e **TM** në mënyrë që të mbahet **tensioni** brenda kufijve të caktuar, për të mënjanuar ndërprerjen e furnizimit për tërë regjionin.
- 6.3.2.3 Zvoglimi i qëllimtë i **tensionit** mund të përdoret për të arritur reduktim momental të **ngarkesës**.
- 6.3.2.4 Zvogëlimi i qëllimtë i **ngarkesës** gjithashtu mund të përdoret për të arritur reduktim momental të **ngarkesës** në përputhshmëri me **Kodin e Rrjetit**.
- 6.3.2.5 Ndërprerja emergjente e tërësishme e **ngarkesës** mund të bëhet në **Sistemin e Shpërndarjes** ose të **Transmisionit** për arsye të mungesës në **furnizim** ose arsyeve tjera.
- 6.3.2.6 Me rastin e mungesës së **furnizimit** për një periudhë më të gjatë kohore atëherë ndërprerja në mënyrë të planifikuar rotative mund të përdoret që të ndahet energjia elektrike në mes të **përdoruesve** të ndikuar (atyre që s'kanë energji elektrike).

6.3.3 Implementimi i Kontrollimit të Ngarkesës

- 6.3.3.1 Me rastin e aplikimit të **kontrollimit të ngarkesës** nga **OSSH** në bazë të instruksioneve ose të kërkesës nga **OST** në mënyrë që të mbrohet tërë sistemi, atëherë **OSSH** i kërkohet që kërkesave të u përgjigjet me kohë dhe do të veprojë të informojë **Përdoruesit** aq sa është praktikisht e mundur.
- 6.3.3.2 Procedurat për reduktimin e **ngarkesës** duke përfshirë politikat e reduktimit, rotacionin e reeduktimit të **ngarkesës** dhe komunikimit me **konsumatorë** të përfshihen në planin e shpërndarjes të reduktimeve të **ngarkesës** të aprovuar nga **OSSH**.

6.4 Komunikimi Operues dhe Veprimi

6.4.1 Qëllimi dhe Objektivat e Komunikimit Operues

6.4.1.1 Komunikimi operues përcakton kërkesat për shkëmbim të informatave në raport me operimin dhe (ose) mundësitë e **Sistemit të Shpërndarjes** ose të instalimit të çdo **Përdoruesi** që është i **kyçur** në **Sistemin e Shpërndarjes** të cilët kanë pas ose mund të kenë, ose do të mund të kenë efekt në operimin e **Sistemit të Shpërndarjes** ose në instalimin e çdo **Përdoruesi** tjetër.

6.4.1.2 Objektivat e komunikimitoperues dhe veprimit janë që të siguroj shkëmbim të informatave ashtu që implikimet e operimit dhe (ose) mundësive mund të konsiderohet edhe mundësia e rrezikut që shfaqet nga kjo, mund të vlerësohet dhe mund të merret veprim konkret nga grupi i caktuar në mënyrë që të mirëmbaj tërësinë integrale të sistemit si dhe instalimet e **përdoruesve**. Komunikimi operues nuk kërkon që të merret me asnjë veprim që shfaqet nga shkëmbimi i informatave por thjesht merret me shkëmbim.

6.4.1.3 Komunikimi operues zbatohet nga **OSSH** dhe të gjithë **Përdoruesit e Sistemit të Shpërndarjes** në tërë territorin e Kosovës:

- (a) **Konsumatorët e privilegjuar të kyçur** në **Sistemin e Shpërndarjes** dhe **konsumatorët e Tensionit të Mesëm** për të cilët **OSSH** mendon se është e domosdoshme;
- (b) Centralët e pavarura të **Gjenerimit** me kapacitet më të madh se 2 MW;
- (c) **Konsumatorët e Privilegjuar** dhe ata **Vet-Prodhuës** për të cilët **OSSH** mendon se është e domosdoshme.

6.4.2 Procedurat për komunikim operues dhe veprim

6.4.2.1 **OSSH** dhe **Përdoruesit e kyçur** në **Sistemin e Shpërndarjes** duhet të emërojnë një person dhe (ose) lokacionin e vend takimit dhe të pajtohen për format e komunikimit për shkëmbimin e domosdoshëm të informatave ashtu që ta bëjnë sa më efektive shkëmbimin e informatave që kërkohen nga komunikimi operues.

6.4.2.2 Pajisjet **SCADA** mund të kërkohen në vendin e **Përdoruesit** për transmetim të informatave dhe të dhënave tek dhe nga **Qendrat Dispeçerike** e **OSSH**-së ose **OST**-së.

6.4.2.3 Informata në mes të **OSSH** dhe **Përdoruesit** mund të shkëmbehen me kërkesë të arsyeshme nga secila palë. **Kërkesa** mund të vazhdoj me operim specifik, ose të jetë në akordim me marrëveshjen e mëparshme për shkëmbim të informatave për ndonjë rast të posaçëm.

Kjo nuk mund të pengoj shkëmbimin vullnetar të informatave të cilat mund të perceptohen të rëndësishme për operim të pajisjes të **Shpërndarjes** ose të **Përdoruesit** në akordim me praktikat e mira industriale.

6.4.2.4 Me rastin e operimit në **Sistemin e Shpërndarjes** ose me marrjen e lajmërimit për operimin në **Sistemin e Transmisionit**, i cili mund të ketë ose ka, sipas opinionit të **OSSH**-së, ndonjë efekt të operimit në lidhjen e pajisjeve të **Përdoruesit** të **kyçur** në **Sistemin e Shpërndarjes**, **OSSH** duhet ta lajmëroj **Përdoruesin**.

6.4.2.5 Me rastin e operimit në pajisjen e **Përdoruesit** të **kyçur** në **Sistemin e Shpërndarjes** i cili mund të ketë ose ka efekt të operimit në **Sistemin e Shpërndarjes**, **Përdoruesi** do të lajmëroj **OSSH**-në në harmoni me komunikimin operues.

6.4.2.6 Lajmërimi në bazë të komunikimit operues do të ketë detaje të mjaftueshme për përshkrimin e operimit, edhe pse nuk duhet që të tregoj arsyen dhe të mundësoj marrësin e lajmërimit që sa më arsyeshëm të ketë qasje në implikimet dhe rreziqet që shfaqen, mirëpo duhet që të përfshijë emrin e individit që raporton mbi operimin. Marrësi mundet që të bëjë pyetje plotësuese të domosdoshme që të qartësohet lajmërimi.

6.4.2.7 Lajmërimi në bazë të komunikimit operues duhet të jepet sa më parë që është e mundur që të lejoj marrësin të konsideroj dhe të vlerësoj implikimet dhe rreziqet që do të shfaqen.

6.4.3 Incidentet e Rënda

6.4.3.1 Kur ndonjë rast në **Sistemin e Shpërndarjes** ka pas ose mund të ketë efekt të rëndësishëm në instalimin e **Përdoruesit** ose kur ndonjë rast në **instalimin e Përdoruesit** ka pas ose do të ketë efekt të rëndësishëm në **Sistemin e Shpërndarjes** rasti do të konsiderohet si incident i rëndë nga **OSSH** në konsultim me **Përdoruesin**. Incidentet e rënda duhet të raportohen me shkrim tek grupi i afektuar në akordim me dispozitat e raportimit të rasteve si në 6.5.

6.4.3.2 Incidenti i rëndë duhet të përfshijë rastet që rezultojnë në, ose mund të rezultojnë në këto:

- Ndryshimi i Tensionit jashtë limitit të parashikuar;
- Frekuenca e Sistemit jashtë limitit të parashikuar; dhe
- Çrregullimi i stabilitetit të Sistemit.

6.5 Raportimi i Rasteve

6.5.1 Qëllimi i Raportimit të Rasteve

6.5.1.1 Raportimi i rasteve parashtron kërkesat për raportim në formë të shkruar për rastet që konsiderohen se janë “Incidente të Rënda” në bazë të komunikimit operues. Informatat në mes të **OSSH**-së dhe **Përdoruesve** të mëdhenj mund të shkëmbehen me kërkesë të arsyeshme nga të dyja palët.

6.5.1.2 Raportimi i rasteve gjithashtu përshkruan analizat e përbashkëta të **incidenteve** të rënda nga involvimi i **Përdoruesit**.

6.5.1.3 Objektivat e raportimit të rasteve paraqesin lehtësimin e përgatitjes të më shumë informatave në detaje në mënyrë të shkruar dhe aty ku është arrijtë **marrëveshja** në mes të **OSSH**-së dhe involvimit të **Përdoruesit**, analizës së përbashkët i këtyre **incidenteve** të rënda të raportuara në mënyrë verbale në bazë të komunikimit operues.

6.5.1.4 Raportimi i rasteve zbatohet për këta **Përdorues** të **Sistemit të Shpërndarjes**:

- **Konsumatorët e privilegjuar të kyçur në Sistemin e Shpërndarjes** për të cilët **OSSH** mendon se është e domosdoshme;
- **Gjeneruesit e pavarur** me kapacitet më të madh se 2 MW;
- **Konsumatorët e Privilegjuar** dhe ata **Vet-Prodhues** për të cilët **OSSH** konsideron se është e domosdoshme.

6.5.2 Procedurat për Raportimin e Rasteve

6.5.2.1 **OSSH** dhe çdo **Përdorues** i specifikuar në paragrafin 6.5.1 duhet të emëroj zyrtar dhe të themeloj forma të komunikimit ashtu që të siguroj efikasitetin e raportimit të rasteve. Zyrtarët e tillë dhe format e komunikimit mund të jenë të njëjtë sikurse ato që janë themeluar në bazë të paragrafit 6.4.

6.5.2.2 Komunikimi duhet, aq sa është e mundur, të jetë direkt në mes të **Përdoruesit** dhe **Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes**. Megjithatë, kjo nuk do të pengoj komunikimin me përfaqësuesit e nominuar të **Përdoruesit**.

6.5.2.3 Në situatën me raportimin e rastit tek **OSSH** në bazë të paragrafit 6.4 dhe që ka qenë përcaktuar më parë nga **OSSH** si rast i **incidentit** të rëndë, një raport i shkruar duhet të dorëzohet tek **OSSH** nga ana e **Përdoruesit** në harmoni me paragrafin 6.5.

6.5.2.4 Në situatën me raportimin e rastit që ka qenë raportuar më parë tek **Përdoruesi** në bazë të paragrafit 6.4 dhe që ka qenë përcaktuar më parë nga **OSSH** si incident i rëndë, një raport i shkruar duhet të dorëzohet tek **OSSH** nga ana e **Përdoruesit** në harmoni me paragrafin 6.5.

6.5.2.5 Një raport duhet të shkruhet ose të paraqitet në formë elektronike dhe të dërgohet tek **OSSH** ose **Përdoruesi** sipas rastit që shfaqet. Ky raport duhet të përmbaj konfirmimin e lajmërimit të dhënë në bazë të paragrafit 6.4 së bashku me më shumë të dhëna që kanë të bëjnë me **incidentin** e rëndë duke përfshi informatat që tashmë janë bërë të njohura për rastin e **incidentit** të rëndë që nga lajmërimi. Raporti duhet të përmbaj së paku çështjet e specifikuar në paragrafin 6.5.4.

6.5.2.6 Raporti në bazë të paragrafit 6.5 duhet të jepet sa më shpejtë që është mundur dhe të jetë sa më praktik pas lajmërimit në bazë të paragrafit 6.4.

6.5.3 Hulumtimet e Përbashkëta

6.5.3.1 Me rastin e raportimit të një incidenti të rëndë dhe me dorëzimin e raportit mbi incidentin në bazë të paragrafit 6.5, çdo grup ose të gjitha grupet mund të kërkojnë me shkrim që të bëhet analiza e përbashkët.

6.5.3.2 Përbërja e një grupi të tillë duhet të jetë i përshtatshëm për incidentin që do të analizohet dhe të jetë i pranueshëm për të gjitha **palët** e involvuara.

6.5.3.3 Analiza e përbashkët do të bëhet vetëm atëherë kur të gjitha **palët** janë të involvuara dhe që pajtohen për këtë. Forma dhe rregullat si dhe procedurat për të gjitha çështjet e ndërlidhura me analizat e përbashkëta duhet që të pajtohen në kohën e analizës dhe në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje analiza e përbashkët nuk do të kryhet.

6.5.4 Raporti i Shkruar mbi Incidentin e Rëndë

6.5.4.1 Çështjet që duhet të përfshihen me rastin e raportimit në **OSSH** dhe **Gjeneratorët e pavarur** janë:

- a) Data dhe koha e Incidentit e rëndë;
- b) Burimi i informatës;
- c) Lokacioni;
- d) Pajisjet e involvuara;
- e) Personeli i involvuar;
- f) Përshkrim i shkurtër i Incidentit të rëndë;
- g) Detajet për çdo **kërkesë** të kontrollit (hulumtimit) që është ndërmarrë; dhe
- h) Konkluzionet dhe rekomandimet që mund të përdoren.

6.5.4.2 Çështjet që duhet të merren në konsideratë nga **OSSH** janë efektet e arsyeshme mbi **Përdoruesit**, duke përfshirë:

- a) Kohëzgjatjen e incidentit; dhe
- b) Vlerësimi i datës dhe kohës për rikthim në punë normale.

6.5.4.3 Çështjet që duhet të merren në konsideratë nga **Gjeneratorët e pavarur** janë efektet me ndikim në **gjenerim**, duke përfshirë:

- a) Ndërprerjen e **Gjenerimit**;
- b) Arritja e përshtatshme e **Frekuencës**;
- c) Arritja e përshtatshme MVA_r; dhe
- d) Vlerësimi i datës dhe kohës për rikthim në punë normale.

6.6 Testimi i Sistemit

6.6.1 Qëllimi dhe Objektivat e Testimit të Sistemit

6.6.1.1 Paragrafi 6.5.4 përcakton përgjegjësitë dhe procedurat për aranzhimin dhe kryerjen e testit të sistemit që ka ose mund të ketë efekt në sistem të **OSSH**-së ose për **Përdoruesit**. Testet e sistemit janë ato teste që përfshijnë cilindo aplikacion të simuluar ose të kontrolluar të kushteve jo të rregullta, të jashtëzakonshme ose atyre ekstreme në sistemin total ose në çdo pjesë të sistemit total, por që nuk përfshijnë testet e komisionimit ose të ri-komisionimit ose çfarëdo testi tjetër më të ulët.

6.6.1.2 Objektivat e testimit të sistemit janë:

- Që të siguroj se procedurat për aranzhimin dhe kryerjen e testit të sistemit janë ashtu që, aq sa janë praktike, testet e sistemit nuk cenojnë sigurinë e personelit ose të njerëzve dhe që nuk shkaktojnë cenim minimal për sigurinë e **furnizimit**, integritetin e stabilimenteve ose të pajisjeve dhe nuk janë të dëmshme për **OSSH**-ën dhe për **Përdoruesit**; dhe
- Cakton procedurat që vazhdojnë me vendosjen dhe raportimin e testit të sistemit.

6.6.1.3 Testimi i sistemit përdoret për këta **Përdorues** të **Sistemit të Shpërndarjes**:

- a) **Konsumatorët e privilegjuar** të **kyçur** në **Sistemin e Shpërndarjes** për të cilët **OSSH** mendon se është e domosdoshme;
- b) **Gjeneruesit e pavarur** me kapacitet më të madh se 2 MW; dhe
- c) **Konsumatorët e Privilegjuar** dhe ata **Vet-Prodhuës** për të cilët **OSSH** mendon se është e domosdoshme.

6.6.2 Procedurat e Testimit të Sistemit

6.6.2.1 Nëse testi i sistemit është propozuar nga **OSSH** ose nga **Përdoruesi i kyçur** në **Sistemin e Shpërndarjes** ose nëse testi ka ose do të ketë ose mund të ketë efekt në **Sistemin e Transmisionit** atëherë do të përdoren dispozitat e testimit të sistemit ose të **Kodit të Rrjetit**.

6.6.2.2 Testet e sistemit që kanë efekt minimal në **Sistemin e Shpërndarjes** ose në sistemet e të tjerëve nuk do të nënshtrohen këtyre procedurave; efektet minimale do të llogariten në variacionet mesatare të **tensionit, frekuencës** dhe të distorsioneve të formës valore për vlerën jo më të madhe se sa ato që janë definuar në Planifikimin e **Sistemit të Shpërndarjes**.

6.6.2.3 Kur **OSSH** ose **Përdoruesi** tentojnë që të kryejnë testin e sistemit i cili mund të ketë efekt të rëndësishëm në sistemin e të tjerëve, duhet me i dhënë paralajmërim 12 muaj më parë, ose ashtu siç ka qenë marrëveshja nga **OSSH**, dhe duhet të jepet nga personi i cili propozon testin e sistemit (propozuesi i testit) tek **OSSH** ose tek **Përdoruesit** që mund të ndikohen nga një test i tillë i sistemit.

6.6.2.4 Propozimi duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të përmbaj detaje të natyrës dhe propozimit për testin e sistemit të propozuar dhe duhet të indikoj përmasat dhe situatën e stabilimentit ose të pajisjeve që përfshihen në te.

6.6.2.5 Nëse informatat që janë vendosur në paralajmërimin e propozuar konsiderohen se nuk janë të mjaftueshme nga pranuesi atëherë duhet që të kontaktojnë propozuesin e testit më një kërkesë të shkruar për informata të mëtutjeshme që do të jepen, sa më shpejt që është e mundur dhe praktikisht e arsyeshme. **OSSH** nuk kërkohet që të bëjë asgjë në bazë të paragrafit 6.6 derisa nuk është e kënaqur me detajet që ju kanë dhënë në propozim ose në kërkesën pasuese për informata të mëtutjeshme.

6.6.2.6 Nëse **OSSH** dëshiron që të kryen testin e sistemit, **OSSH** duhet të konsideroj se e ka marrë propozimin për testin e sistemit.

6.6.2.7 **OSSH** duhet të ketë koordinim të plotë për testin e sistemit, duke i përdorur informatat që ju kanë dhënë në bazë të paragrafit 6.6 dhe duhet që të identifikoj

vlerësimin e arsyeshëm, që **Përdoruesit** tjerë e jo test propozuesi, mund të ndikohen nga propozimi i testit të sistemit.

6.6.2.8 Duke ndjek pranimin e propozimit për test të sistemit, **OSSH** duhet që të evoluoj ndikimin e testit të sistemit dhe të diskutoj propozimin me **Përdoruesit** e identifikuar që ndikohen nga ky test.

6.6.2.9 Brenda një muaji nga data e pranimin të propozimit për test të sistemit **OSSH** duhet të dorëzoj raport tek propozuesi i testit i cili duhet të përmbaj:

- a) Propozimin për kryerjen e testit të sistemit (duke përfshirë mënyrën se si do të bëhet monitorimi);
- b) Alokimi i llogarisë në mes **palëve** të ndikuara, (është princip gjeneral që shpenzimet i mbulon test propozuesi); dhe
- c) Çështjet tjera që **OSSH** i konsideron të përshtatshme, përcakton procedurat që ndjekën dhe orarin e testit të propozuar dhe këshillon për çdo llogari.

6.6.2.10 Raporti i propozimit duhet të dorëzohet tek të gjithë ata që e kanë marrë paralajmërimin në bazë të paragrafit 6.6.2.3.

6.6.2.11 Nëse raporti i propozimit (ose çdo raport i propozimit të ndryshuar që është bërë në marrëveshje në mes të **OSSH** dhe të test propozuesit) pranohet nga të gjithë marrësit, testi i sistemit mund të vazhdoj më tutje.

6.6.2.12 Së paku një muaj para datës së propozuar të testit të sistemit, **OSSH** duhet të dorëzoj tek të gjithë marrësit e propozimit të paralajmëruar një program i cili në paragrafin 6.6 do të quhet program i testit final duke treguar sekuencat e çkyçjes dhe orarin e tyre, listën e të gjithë punëtorëve të involvuar në kryerjen e testit të sistemit (duke përfshi edhe ata që janë përgjegjës mbi sigurinë e vendpunishtes) dhe çështjet tjera që **OSSH** mendon se janë të rëndësishme.

6.6.2.13 Programi i testit final duhet të detyroj të gjithë marrësit që të veprojnë në akordim me detyrimet që parashtrihen në program në lidhje me propozimin e testit të sistemit.

6.6.2.14 Me përfundimin e testit të sistemit, propozuesi i testit duhet që të jetë përgjegjës për përgatitjen e raportit të shkruar (“raporti final”) të testit të sistemit për dorëzim tek **OSSH**.

6.6.2.15 Raporti final duhet të përfshijë përshkrimin e Stabilimentit dhe (ose) pajisjeve, të testuar dhe të testit të sistemit që është bërë së bashku me rezultatet, konkludimet dhe rekomandimet.

6.6.2.16 Rezultatet e testit duhet të raportohen tek **palët** relevante, duke marrë parasysh çështjet konfidenciale.

6.6.2.17 Të gjitha procedurat e testit të sistemeve duhet që të përshtaten me legjislaturat e përdorura.

6.7 Monitorimi, Testimi dhe Hulumtimi

6.7.1 Qëllimi i Monitorimit, Testimit dhe Hulumtimit

6.7.1.1 Që të kryej përgjegjësitë në mënyrë të rregullt duke marrë parasysh sigurinë, funksionimin dhe veprimin ekonomik të **Sistemit të Shpërndarjes** dhe në përputhje me **kushtet e liçencës, OSSH** duhet të organizoj dhe të kryej monitorimin, testimin dhe analizën e efektit të pajisjeve elektrike të **Përdoruesit** ose të **stabilimenteve** në **Sistemin e Shpërndarjes**.

6.7.1.2 Objektivi i monitorimit, testimit dhe hulumtimit është që të specifikohen kërkesat e **OSSH** për testimin dhe (ose) monitorimin e **Sistemit të Shpërndarjes** që të siguroj që **Përdoruesit** nuk veprojnë jashtë parametrave teknik që kërkohen nga Kushtet e Përgjithshme dhe Operimi i **Sistemit të Shpërndarjes**.

6.7.1.3 Monitorimi dhe testimi përdoret për këta **Përdorues** të **Sistemit të Shpërndarjes**:

- a) Të gjithë **Gjeneratorët** e Pavarur; dhe
- b) Të gjithë **Konsumatorët** që janë të **kyçur** në **Sistemin e Shpërndarjes**.

6.7.2 Procedurat e Monitorimit, Testimit dhe Hulumtimit

6.7.2.1 **OSSH** duhet që kohë pas kohe, të përcaktoj nevojën për testim ose të monitoroj kualitetin e **furnizimit** në pika të ndryshme në **Sistemin e Shpërndarës**.

6.7.2.2 Kërkesat për testim specifik dhe (ose) monitorim mund të iniciohen nga marrësit e ankesave specifike për shkak të kualitetit të **furnizimit** në **Sistemin e Shpërndarjes**.

6.7.2.3 Kur kërkohet testimi ose monitorimi në **Pikën e Kyçjes** me **Përdoruesin** atëherë **OSSH** duhet që të këshilloj **Përdoruesin** e involvuar si dhe që t'i prezantoj **Përdoruesit** rezultatet për testin e tillë.

6.7.2.4 Kur **Përdoruesi** vepron jashtë limiteve teknike të përcaktuara në **Kodin e Shpërndarjes** atëherë **Përdoruesi** duhet që të korrigjoj situatën ose të çkyçë menjëherë aparaturat që shkaktojnë probleme nga aparatura e tij, që është e lidhur me **Sistemin e Shpërndarjes** ose brenda afatit siç është paraparë në **marrëveshje** me **OSSH**-ën.

6.7.2.5 Përsëritja e vazhdueshme e parregullsive dhe jogatishmëria apo pamundësia që të përmirësoj situatën e tillë do të rezultojë me atë që **Përdoruesi** të çkyçet në harmoni me **Marrëveshjen e Kyçjes**.

6.7.2.6 **OSSH** duhet që kohë pas kohe të monitoroj efektet e **Përdoruesit** në **Sistemin e Shpërndarjes**.

6.7.2.7 Monitorimi kryesisht bëhet në lidhje me **Fuqinë Aktive, Reaktive** ose me lëkundjet, **harmonikët** që transferohen përgjatë **Pikës së Kyçjes**.

6.7.2.8 Kur **Përdoruesit** eksportojnë ose importojnë **Fuqi Aktive** dhe **Reaktive** në masë siç është përcaktuar në **Marrëveshjen e Kyçjes** ose shkakton parregullsi, **OSSH** duhet të informoj **Përdoruesin** dhe **Përdoruesi** duhet të kufizoj fuqinë e transferuar sipas parametrave të specifikuar.

6.7.2.9 **OSSH** duhet të kontrolloj, kohë pas kohe që **Përdoruesit** të veprojnë në përputhshmëri me kërkesat e **marrëveshjes** për mbrojtje dhe vendimeve për mbrojtje.

6.8 Normat e Sigurisë Industriale

6.8.1 Qëllimi dhe Objektivat e Sigurisë Industriale

6.8.1.1 Normat e Sigurisë Industriale specifikojnë kriteret për sistemin e menaxhimit të sigurisë që duhet të përdoren nga **OSSH**, ashtu që ti plotësoj kërkesat, mbi kushtet dhe obligimet e **Licencës** së **OSSH**-së.

6.8.1.2 Kriteret e ngjashme dhe standardet për sistemin e menaxhimit të sigurisë duhet të plotësohen nga **Përdoruesit** e tjerë të **Sistemit të Shpërndarjes** kur kryejnë punë ose testime në **vendin e kyçjes (pika kyçëse)** me **OSSH**-ën.

6.8.1.3 Objektivi i koordinimit të sigurisë është që të vendos kriteriumet për menaxhimin e sigurisë që do të përdoren për të garantuar sigurinë e personave që punojnë në **Sistemin e Shpërndarjes** dhe në ose përgjatë **Kufijve Pronësor**.

6.8.1.4 Normat e sigurisë specifikojnë kriteret e menaxhimit të sigurisë që përdoren nga **OSSH** dhe për këta **Përdorues** të **Sistemit të Shpërndarjes**:

- a) Të gjithë **Gjeneratorët** e Pavarur;
- b) **Konsumatorët e privilegjuar**
- c) Çdo **palë** tjetër që me arsye është specifikuar nga **OSSH** duke përfshi **Përdoruesit** e **kyçur** në **Tensionin e Ulët** ose të **Mesëm** për seksionet e përshtatshme nga normat e sigurisë atëherë kur është e nevojshme; dhe
- d) Inspektor të **OSSH**-së ose **Përdoruesit** në **Sistemin e Shpërndarjes** ose përgjatë **kufijve pronësor**.

6.8.2 Procedurat e Sigurisë Industriale

6.8.2.1 Principet dhe procedurat e menaxhimit të sigurisë (sistemi i menaxhimit të sigurisë) për të garantuar shëndetin dhe sigurinë e të gjithë personelit relevant duhet që të

specifikohet nga **OSSH** dhe **Përdoruesit** për punë në sistemet e tyre ose **Stabilimente** ose pajisje që u përkasin atyre.

6.8.2.2 Duhet të ketë **marrëveshje** të përbashkët në mes të **OSSH-së** dhe **Përdoruesve** ku sistemi i menaxhimit të sigurisë do të përdoret për vendpunishtet ku ekzistojnë **kufinjë pronësor** dhe dokumentimi i masave të sigurisë që duhet të ndërmerren dhe të mirëmbahen.

6.8.2.3 Duhet të shkruhet një autorizim për personelin që kryejnë punët e kontrollimit, operimit, ndonjë pune tjetër dhe testimin e stabilimenteve ose pajisjeve që formojnë pjesë ose që janë të **kyçur** në **Sistemin e Shpërndarjes**.

6.8.2.4 Duhet të ketë **marrëveshje** të përbashkët në mes të **OSSH-së** dhe **Përdoruesve** që specifikon përgjegjësitë për sistemin ose kontrollimin e pajisjeve që do të garantoj që vetëm njëra palë është përgjegjëse për çdo pjesë të stabilimentit ose të pajisjeve në çdo kohë.

6.8.2.5 **OSSH** dhe çdo **Përdorues** duhet që gjatë tërë kohës të emëroj një person ose persona që të jenë përgjegjës për koordinimin e sigurisë në sistemet respektive.

6.8.2.6 **OSSH** dhe çdo **Përdorues** duhet të mirëmbaj një sistem të përshtatshëm për dokumentim i cili regjistron të gjitha operimet relevante që kanë ndodhur në **Sistemin e Shpërndarjes** ose në sistemet tjera që janë të **kyçur** në te dhe koordinimin e masave të ndërmarra relevante për sigurinë e punës.

6.8.2.7 Diagramet që tregojnë informata të mjaftueshme për personelin e kontrollimit që do të kryejnë punët e tyre duhet të shkëmbehen në mes të **OSSH-së** dhe **Përdoruesit** ashtu siç kërkohet.

6.8.3 Siguria në vendin e kyçjes/Pika e Kyçjes së Përdoruesit

6.8.3.1 Procedurat në vijim vendosin kërkesat themelore për sigurinë, për operimin dhe **pikën e kyçjes** së **OSSH-së**. Këto procedura janë të domosdoshme që të garantojnë

sigurinë e të gjithë atyre që mund të punojnë në çdo anë të **pikës kyçëse** ose në **pikën kyçëse** (në kufijtë).

- a) Rregulla të shkruara për sigurinë në punë dhe për procedurat komunikuese duhet të jenë në dispozicion dhe të përdoren nga të gjithë personat që mund të punojnë në ose që i përdorin pajisjet në **pikën kyçëse**;
- b) Pajisjet elektrike që **kyçen** në të dy anët e **pikës kyçëse** dhe pajisjet e **pikës kyçëse** duhet të jenë nën kontroll të personit të autorizuar në të dy anët;
- c) Çdo pjesë e pajisjes duhet të kontrollohet nga vetëm një person i identifikuar në çdo kohë;
- d) Masat adekuate për **izolim** duhet të sigurohen në **pikën kyçëse**, që puna të kryhet sigurt në të dy anët e **pikës kyçëse**;
- e) Kur është e domosdoshme që të mënjanohet rreziku duhet të sigurohen në të dy anët e **pikës kyçëse** pajisje adekuate për tokëzim që të mundësoj kryerjen e punës në mënyrë të sigurtë në **pikën kyçëse** ose në të dy anët e **pikës kyçëse**;
- f) Hapësirë adekuate për punë, masa adekuate për qasje dhe dalje dhe, kur është e nevojshme, ndriçim adekuat duhet të sigurohet për punën që kryhet në të gjitha pajisjet elektrike që mund të shkaktojnë rrezik;
- g) Të gjitha pajisjet elektrike duhet që të identifikohen sa më përshtatshëm kur është e nevojshme që të mënjanohet rreziku; dhe
- h) Instalimet elektrike dhe pajisjet duhet që të plotësojnë të gjitha kërkesat statusore relevante.

6.8.4 Rregullat e Sigurisë Industriale

6.8.4.1 Operimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të **Përdoruesve** duhet të kryhen vetëm nga personeli i autorizuar. Para komisionimit të parë të Stabilimentit procedurat e operimit duhet të aranzhohen me **OSSH**-në.

6.8.4.2 Instruksionet për operim dhe (ose) përtokëzimin e pajisjeve elektrike të **Përdoruesve** duhet që të paraqiten (shihen) qartë në dhomën e ndërprerësve të **Përdoruesve** të **Tensionit të Ulët** dhe të **Mesëm**.

- 6.8.4.3 Rregullat e sigurisë (**Transmisioni, Shpërndarja dhe Përdoruesit**) përcaktojnë procedurat e sigurisë që duhet të zbatohen për të gjithë personelin që punon në ose në afërsi të **Sistemit të Shpërndarjes** të stabilimenteve ose të pajisjeve.

6.9 Siguria e Furnizimit

- 6.9.1 Standardi i sigurisë për **Sistemin e Shpërndarjes** është i përcaktuar në “Standardet e Sigurisë së **Sistemit të Shpërndarjes** dhe të Planifikimit”.
- 6.9.2 **OSSH** do të bëjë përpjekjet të arsyeshme që të mirëmbajë furnizimin e një sistemi. Kjo nuk mund të sigurohet nëse prishjet, mirëmbajtja e planifikuar dhe ndërprerjet gjatë punëve të reja dhe rrethanat tjera të cilat janë jashtë kontrollit të **OSSH**-së mund të shkaktojnë pengesa. Në raste të tilla, **OSSH** do t'i bëjë përpjekjet e arsyeshme për të rikthyer **furnizimin** apo **kyçjen** sa më shpejt që është e mundshme por nuk do të mbaj asnjë përgjegjësi për ndonjë dëmtim të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë apo humbje të ndërlidhura të shkaktuara nga **Përdoruesi**.
- 6.9.3 Udhëzimet për llojet e ndryshme të ndërprerjeve janë si në vijim:

Ndërprerjet gjatë prishjeve: **OSSH** do të përpjekjet të kthej qasjen në sistem brenda njëzet e katër orëve (24 h). Nën kushte të stuhive të mëdha koha e **ndërprerjes** mund të jetë më e gjatë dhe në rrethana të tilla **OSSH** do të mundohet të mbajë **Përdoruesin** të njoftuar me zhvillimin e ngjarjeve.

Ndërprerjet e Planifikuara: **OSSH** do të lajmërojë së paku tri ditë më herët për **ndërprerjet e planifikuara të furnizimit**. Në disa situata – për të lehtësuar riparimet emergjente apo **ndërprerjet** lokale të cilat ndikojnë në një numër të vogël të konsumatorëve – duhet të jipet lajmërimi në afat më të shkurtë.

Shkurtime e Furnizimit: Në disa rrethana, mund të jetë e domosdoshme të kërkohet nga **konsumatorët** të reduktojnë **ngarkesën** apo ti përdorin furnizimet rezervë aty ku është e përshtatshme. Në këto situata **OSSH** do të mundohet të siguroj qasjen në sistem. Në rastet ekstreme kur kjo nuk do të ishte e mundur **OSSH** do të bëjë përpjeke që së paku të lajmëron dy ditë më parë **Përdoruesit**.

Reduktimet: Në situata të jashtëzakonshme mund të ketë **ndërprerje** të prodhimit dhe kështu mund të nevojiten reduktime. Nëse është e mundur në këto rrethana **OSSH** do të njoftojë **konsumatorët** por pasi që kjo shpesh-herë është një situatë emergjente kjo mund të mos jetë e mundur.

6.9.4 **OSSH** nën rrethana të caktuara mund t'i ç'kyç **konsumatorët** nga **furnizimi**. Këto rrethana do të përfshijnë:

- a) Kur instalimi i **konsumatorit** apo përdorimi i energjisë elektrike është i tillë që të pengojë operimin e kënaqshëm të **Sistemit të Shpërndarjes** apo **Transmisionit** apo të shkaktojë pengesa tek **konsumatorët** tjerë.
- b) Aty ku **OSSH** konsideron se instalimi i **konsumatorit** është i rrezikshëm.
- c) Ku ndryshimet, riparimet, renovimet apo mirëmbajtja e **Sistemit të Shpërndarjes** apo aseteve të **OSSH** apo mjetet e lidhjes kërkojnë de – energjizimin e **pikës kyçëse**.
- d) Kur **konsumatori** zgjeron furnizimin për t'u përdorur nga ndonjë palë tjetër të cilën **OSSH** e konsideron të jetë **konsumator** i privilegjuar.
- e) Në ndonjë rrethanë tjetër në të cilën zgjedhja është e domosdoshme apo e përshtatshme për t'i mundësuar **OSSH** të jetë në përputhje me **Kodin e Shpërndarjes** dhe të operojë me **Sistemin e Shpërndarjes** sipas një praktike të mirë industriale apo që kërkohet nga Rregulli për shkyçjen të hartuar nga **ZRrE**.

Kapitulli VII

7. Regjistri i të Dhënave Teknike

7.1 Hyrje

7.1.1 Seksione të ndryshme të **Kodit të Shpërndarjes** kërkojnë që **Përdoruesit** të paraqesin të dhënat teknike tek **OSSH**.

7.1.2 Regjistri i të Dhënave Teknike (RDhT) siguron një paraqitje të përgjithshme të të gjitha kërkesave për informata të një tipi të veçantë. Çdo **përdorues** referohet tek paraqitja e përshtatshme për shfaqje të të dhënave totale të kërkuara për çdo rast.

7.1.3 RDhT specifikon procedurat dhe kohën për furnizim me të dhëna dhe ri-freskim të kohë pas kohshëm. Atëherë kur koha është e përcaktuar me një orar të saktë në seksionet e tjera në **Kodin e Shpërndarjes**, nuk është e nevojshme për përsëritje të tërë RDhT.

7.1.4 Në rastin kur **Gjeneratori** kërkon të **kyçet** në **Sistemin e Shpërndarjes**, atëherë aranzhimin për orarin kohor dhe diskutimet për **kyçje**, duhet të bëhen me **OSSH**-në.

7.2 Fushë veprimi

Përdoruesit për të cilët përdoret Seksioni për RDhT janë:

1. **Gjeneratorët e Pavarur;**
2. **Konsumatorët e privilegjuar;** dhe
3. **Konsumatorët e Tensionit të Mesëm** ku **OSSH** konsideron se është e domosdoshme.

7.3 Procedurat dhe Përgjegjësitë

7.3.1 Derisa nuk është specifikuar ndryshe ose është arrijtë marrëveshja nga **OSSH** çdo **Përdorues** duhet të paraqet të dhënat siç janë definuar në 7.4 dhe orari i bashkangjitur.

7.3.2 Ndryshimi i të dhënave rishikohet në bazë vjetore që të garantoj saktësi kontinuale ose relevante. **OSSH** duhet që të inicioj me shkrim këtë rishikim dhe **Përdoruesit** duhet që të përgjigjen me shkrim.

7.3.3 Atëherë kur të dhënat e mundshme duhet të dorëzohen në formë standarde dërgohen tek **Përdoruesi** nga ana e **OSSH**-së.

7.3.4 Nëse **Përdoruesi** dëshiron që të ndërron ndonjë pjesë të të dhënave atëherë së pari duhet të diskutohet me **OSSH**-në në mënyrë që të merren në konsiderim implikimet dhe ndryshimet. Nëse është arritur pajtueshmëria, të konfirmohet me dorëzimin e formës së të dhënave të rishikuara me konfirmim të shkruar.

7.3.5 Kohë pas kohe **OSSH** mund të ndryshoj kërkesat për të dhënat, **Përdoruesit** e mirëfilltë duhet të këshillohen me këto ndryshime ashtu siç ndodh dhe me një orar kohor të kthimit të përgjigjes.

7.4 Të Dhënat që duhet të Regjistrohen

7.4.1 Metoda e emërimit duhet të jetë e njëjtë me metodën e emërimit në **Kodin e Rrjetit** kurse disa emërtime nga **Kodi i Shpërndarjes** nuk kërkohen.

7.4.2 Metoda e emërtimeve 1(a), 1(b), dhe 1(c) – Informatat teknike të **Gjeneratorëve** të pavarur.

7.4.3 Metoda 2- Parashikimi i Kërkesës – siç është përshkruar në Kapitullin 7, parashikimi i **kërkesës** dhe **gjenerimit** për **Përdoruesit** e definuar në fushë veprim.

7.4.4 Metoda 3 (a) dhe (b) – Planifikimi i operimit – ashtu siç është përshkruar në Kapitullin 7, ndërpret informatat e planifikuara.

7.4.5 Metoda 4 (a) dhe (b) – dizajni i informatave të sistemit- përfshinë të dhënat teknike të sistemit.

7.4.6 Metoda 5 – karakteristikat e **Ngarkesës** – përfshinë të dhënat e parashikuara për pikat e **ngarkesës** që tregojnë p.sh. **ngarkesën** maksimale, pajisjet që përfshijnë **ngarkesën** dhe përbërjen e **harmonikëve** të **ngarkesës**.

7.5 Planifikimi (lista) i (e) të Dhënave

Planifikimi që përdoret për çdo klasë të **përdoruesve** është dhënë më poshtë:

Numri i Listës	Titulli	Përdorimi për:
Lista 1 (a)	Njësitë e Gjenerimit	Gjeneratorët e Pavarur duke përfshi Konsumatorët e Privilegjuar dhe Konsumatorët Vet-Prodhuës.
Lista 1 (b)	Njësitë e Gjenerimit	Gjeneratorët e Pavarur me operim paralel
Lista 1 (c)	Njësitë e Gjenerimit	Gjeneratorët e Pavarur > 2MW.
Lista 1(d)	Njësitë e Gjenerimit	Për të gjithë Gjeneratorët me erë
Lista 1 (e)	Njësitë e Gjenerimit	Për Gjeneratorët me erë, më të vogël se 5 MW
Lista 2	Parashikimi i Ngarkesës	Gjeneratorët e Pavarur > 2MW; Konsumatorët e privilegjuar.
Lista 3 (a)	Planifikimi i Operimit (Ndërprerja)	Gjeneratorët e Pavarur.
Lista 3 (b)	Planifikimi i Operimit (Stabilimenti dhe Pajisjet)	Konsumatorët e privilegjuar, Gjeneratorët e Pavarur dhe Konsumatorët me Vet-Prodhim
Lista 4 (a)	Dizajnimi i Sistemit	Gjeneratorët e Pavarur; Konsumatorët e privilegjuar; Konsumatorët e TM nëse këshillohet nga OSSH
Lista 4 (b)	Dizajnimi i Sistemit	Gjeneratorët e Pavarur nëse punojnë në Paralel;
Lista 5	Karakteristikat e Ngarkesës	Gjeneratorët e Pavarur; Konsumatorët e privilegjuar.

Planifikimi 1(a)

Të Dhënat e Njesisë së Gjenerimit

Për të gjithë Gjeneratorët e Pavarur duke përfshi Konsumatorët e Privilegjuar si dhe Konsumatorët Vet-Prodhuar

Përshkrimi i të Dhënave

Përshkrimi i të Dhënave	Njësitë
Detajet e Vend-punishtes	Tekst
Emri i Kontaktit	Tekst
Model i Gjeneratorit	Tekst
Lloji i Njesisë Gjeneruese	Tekst
Lloji i turbinës	Tekst
Parashikimi i regjimit të Operimit	Tekst
Tensionet në bornat e gjeneratorit	kV
Fuqia nominale	kVA
Fuqia aktive nominale	kW
Fuqia aktive maksimale dalëse	kW
Fuqia reaktive maksimale dalëse	kVAr
Kontributi i Nivelit të Lidhjes së Shkurtë	MVA
Metoda e Kontrollit të Tensionit	Tekst
Detajet e Bllok-Transformatorit	Tekst

Planifikimi 1 (b)

Të dhënat e Njesisë së Gjenerimit

Për Gjeneratorët e Pavarur me Operim Paralel

Përshkrimi i të Dhënave	Njësitë
Detajet e inxhinieringut duhet të përfshijnë:	Tekstin/Diagramin skematik
Niveli Relevant i Tensionit	
Madhësia e Gjeneratorit dhe konfigurimi i mbështjellave	
Madhësia e Transformatorit, fuqia, impedansa e lidhjes së shkurtë, herësi, dhe konfigurimi i mbështjellave	
Lokacioni i ndërprerësve	
Vlera maksimale e lidhjes së shkurtë trefazore	kA
Lokacioni i furnizimeve alternative	
TMRr/TMT herësi dhe lokacionet	
Aranzhimi mbi sinkronizimin	
Llojet e releve dhe lokacioni	
Lokacioni i korrektimit të Faktorit të Fuqisë	
Konstanta e Inercionit	sek
Rezistenca e Statorit	Njësi relative
Reaktansa e Boshtit Direkt: <ul style="list-style-type: none"> • Sub-tranziente • Tranziente • Sinkrone 	Njësi relative
Konstanta Kohore: Boshti Direkt <ul style="list-style-type: none"> • Sub-tranziente • Tranziente 	sek.
Sekuenca nulare: <ul style="list-style-type: none"> • Rezistenca • Reaktansa 	Njësi relative
Sekuenca Negative: <ul style="list-style-type: none"> • Rezistenca • Reaktansa 	Njësi relative

Bllok-Transformatori:	
<ul style="list-style-type: none"> • Rezistenca • Rektansa • Fuqia nominale • Aranzhimi rregullatorit të tensionit • Grupi i lidhjes • Përtokëzimi i neutrit 	<p>Njësi relative</p> <p>Njësi relative</p> <p>MVA</p>
Vlera e Rrymës që ndodhë për shkak të lidhjes së shkurtër metalike në ndërprerësin kryesor të qarkut	Fletë për Kalkulim
Aranzhimi i pikës kyçese	Tekst/Diagramin
Detajet e Qarkut Mbrojtës si dhe Mbikqyrja e Ndërprerjeve të Qarkut	Tekst/ Diagramin
Detajet e Releve që do të Përdoren duke përfshirë rangun, vendosjen e propozuar dhe kalkulimin që do të përdoren për vendosjen e releve	Tekst
Detajet e Faktorit Rregullues të Fuqisë	Tekst/ Diagramin

Planifikimi 1 (c)

Të dhënat e **Njesisë së Gjenerimit**

Për **Gjeneratorët e Pavarur** më të mëdhenj se 2 MW

Përshkrimi i të Dhënave	Njësitë
Lloji i Turbinës	Tekst
Fuqia e dukshme	MVA
Lloji i eksitimit	Tekst
Rregullatori Automatik i Tensionit (AVR)	Diagramin
Bllok diagrami i modelit për Rreg.Automatik të tensionit duke përfshirë të dhënat për konstantën kohore të përforcuesit dhe ate rivepruese si dhe limitin e kontrollimit të tensionit	Tekst
Rregullatori i shpejtësisë si dhe të dhënat e turbinës	Diagramin

Bllok diagrami për modelin e rregullatorit të shpejtësisë së gjeneratorit të centralit që tregon detajet e rregullatorit, sistemin kontrollues, vlerësimin e turbinës si dhe Fuqinë maksimale	Tekst
Fuqia nominale aktive dhe reaktive (kapaciteti) për njësi si dhe për tërë centralin gjeneratorik	MW MVA _r
Fuqia minimale aktive dhe reaktive për njësitë gjeneratorike si dhe për tërë centralin gjeneratorik.	MW MVA _r
Kërkesa për shpenzime vetanake për njësit gjeneratorike si dhe për tërë centralin gjeneratorik në konditat minimale të gjenerimit	MW MVA _r
Kërkesa për shpenzime vetanake për njësit gjeneratorike si dhe për tërë centralin gjeneratorik në konditat normale të gjenerimit (të regjistruara)	MW MVA _r

Planifikimi 1(d)

Gjenerimi i të Dhënave të Pajisjes (Njësisë)-Modelet Dinamike për **Centralet e Gjeneratorëve** me erë

Për të gjithë **Centralet e Gjeneratorëve** me erë

(Si alternativë, **Centralet e Gjeneratorëve** me erë me Kapacitet të Regjistruar më pak se 5 MW duhet me i paraqitë këto të dhëna që parashtrohen në Planifikimin 1 (e)).

Përshkrimi i të Dhënave	Njësitë
Modeli Dinamik	PSS/E formati (ose format tjetër në pajtueshmëri me OST)
Parametrat e Modelit Dinamik	Ashtu siç kërkohet me modelin dinamik
ose	

Modeli Dinamik më parë i paraqitur tek **OSSH** ose **OST**

Titulli/version i modelit dinamik	
Të Dhënat e Dërguara tek OST/OSSH	
Nga kush janë dërguar	
Për ku adresohen	
Mënyrat e Adresimit	

Planifikimi 1(e)

Gjenerimi i të Dhënave të Pajisjes (Njësisë)-Modelet Dinamike për Centralet e Gjeneratorëve me erë

Centralet e Gjeneratorëve me erë me kapacitet të regjistruar më pak se 5 MW, ku të dhënat e specifikuara në Planifikimin 1 (d) nuk janë siguruar (paraqitur).

Përshkrimi i të Dhënave	Njësitë
Teknologjia Gjen. Erës	Shpejtësia fikse e stall-ës e rregulluar Shpejtësia fikse e pitch-it e rregulluar Shpejtësia fikse e pitch-it e rregulluar me resistencë variabile të rotorit Shpejtësia variabile me ushqim të dyfishtë të gjeneratorit indukues Shpejtësia variabile me gjenerator të sinkronizuar dhe me konvertor të vlerësuar plotësisht Tjetër
Gjen.Erës Prodhuesi	
Lloji i Gjen. Erës - Prodhuesit me shënimet	
Prodhuesi i Gjeneratorit	
Parametrat e Gjeneratorit	Ashtu siç është specifikuar në Planifikimin 1 (b)

Planifikimi 2

Parashikimi i Kërkesës

(A) Njësitë Gjeneruese më të mëdha se 2 MW të cilat nuk janë subjekt i Qendrës Nacionale të Dispeçingut

Përshkrimi i të Dhënave	Viti 0	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6
B Energjia dalëse (fuqia aktive maksimale vjetore MW për ¼ e orës)							
K Gjenerimi i Parashikuar i energjisë (MWh)							
Periudhat e Ndërprerjeve të planifikuara Data: Fillimi i ndërprerjeve							
Periudhat e Ndërprerjeve të planifikuara Data: Fundi i ndërprerjeve							

atorët e privilegjuar dhe Konsumatorët e Tensionit të Mesëm për të cilët OSh konsideron se është e përshtatshme

Përshkrimi i të Dhënave	Viti 0	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6
Energjia Dalëse (fuqia aktive maksimale vjetore MW për ¼ e orës) dhe faktori i Fuqisë							
Parashikimi i Kërkesës vjetore të energjisë (MWh)							
Periudhat e Ndërprerjeve të planifikuara Data: Fillimi i ndërprerjeve							
Periudhat e Ndërprerjeve të planifikuara Data: Fundi i ndërprerjeve							

Vërejtje: Viti 0 është Viti aktual

Planifikimi 3 (a)

Planifikimi i Operimit – Planifikimi i Ndërprerjes

Për Gjeneratorët e Pavarur

Përshkrimi i të Dhënave	Njësitë	Periudha Kohore	Lloji i të Dhënave
<p>Për Njësitë Gjeneruese individuale numri i njësisë dhe Kapaciteti Gjenerues i Centralit.</p> <p>Preferohet data më e hershme e fillimit dhe data më e vonshme e përfundimit.</p>	MW	0 deri 52 javë	Programi i Përshtatshëm i Ndërprerjeve
<p>Për Njësitë Gjeneruese individuale numri i njësisë dhe Kapaciteti Gjenerues i Centralit.</p> <p>Preferohet data më e hershme e fillimit dhe data më vonshme e përfundimit</p>	MW	Vitet 2 deri 3	Programi Provisional i Ndërprerjeve
<p>Për Njësitë Gjeneruese individuale numri i njësisë dhe Kapaciteti Gjenerues i Centralit.</p> <p>Preferohet data më e hershme e fillimit dhe data më e vonshme e përfundimit</p>	MW	Vitet 4 deri 7	Programi Indikativ i Ndërprerjeve

Planifikimi 3(b)

Planifikimi Operativ

Stabilimentet dhe Pajisjet

Për Gjeneratorët e Pavarur, Konsumatorët e privilegjuar dhe Konsumatorët Vet-
Prodhues

Përshkrimi i të Dhënave	Njësitë	Periudha Kohore që Mbulohet
Përdoruesit sigurojnë OSSH me detaje për propozimin e ndërprerjeve që mund të kanë ndikim në performansën e Sistemit të Shpërndarjes, Detajet e testit të ndërprerjeve, rrezikut të ndërprerjeve dhe informatave tjera ku janë të njohura që mund të kenë efekt në sigurinë dhe stabilitetin e Sistemit të Shpërndarjes	Datat kohore	0 deri 52 javë
Përdoruesit sigurojnë OSSH me detaje për propozimin e ndërprerjeve që mund të kenë ndikim në performansën e Sistemit të Shpërndarjes, Detajet e testit të ndërprerjeve, rrezikut të ndërprerjeve dhe informatave tjera ku janë të njohura që mund të kenë efekt në sigurinë dhe stabilitetin e Sistemit të Shpërndarjes.	Datat kohore	Vitet 1 deri 2

Planifikimi 4(a)

Informatat mbi Dizajnin e Sistemit

Gjeneratorët e Pavarur dhe Konsumatorët e privilegjuar nëse sugjerohen nga **OSSH**

Përshkrimi i të Dhënave	Njësitë
<i>Kompensimi Reaktiv</i>	MVAr
Rektansa e çdo kapaciteti ose Qelule dhe çdo reaktanse të lidhur në seri	Njësi relative
Vlera e çdo shant reaktanse veç e veç	MVAr
<i>Vlera individuale e çdo Qelule Kapacitive</i>	MVAr
Detajet e çdo kontrole logjike, automatike siç është karakteristika operuese që mund të përcaktohet	Tekst/ Diagramin
<i>Pikat e kyçjes në sistem</i>	
<i>Susceptansa ekuivalente e Rrjetit</i>	Njësi relative
Detajet e susceptansës ekuivalente të rrjetit që referohet tek lidhja me Sistemin e Shpërndarjes përfshijnë: Shant rektorët që janë pjesë përbërëse të sistemit të kablllove që normalisht nuk janë në dhe jashtë operimit pavarësisht nga kabllot. Ndërsa nuk përfshijnë: Kompensimet reaktive me çkyçje të pavarur të kyçur në sistemin e përdoruesit dhe Çdo susceptansë e cila bënë pjesë në ngarkesën aktive dhe reaktive të përdoruesit	
Burimet e rrymave të lidhjeve të shkurta	
Herësi X/R në kondita maksimale dhe minimale të rrymave të lidhjeve të shkurta nga të gjithë kontribuesit (makinat elektrike)	R+jX
Informatat mbi Impedansën ekuivalente të rrjetit të kërkuar nga OSSH	
Impedansa e ndërlidhjes	

Planifikimi 4(b)

Informata mbi dizajnin e Sistemit

Për **Gjeneratorët** e Pavarur që Operojnë Paralel me Sistemin

Përshkrimi i të Dhënave	Njësitë
Impedansa e Interkonekcionit	
Rezistenca e Sekuencës Pozitive	%
Rezistenca e Sekuencës Inverze	%
Rezistenca e Sekuencës Zero	%
Susceptansa	
Nëse OSSh konsideron se impedansa është e ulët, atëherë duhet të kërkohen më shumë të dhëna	
<i>Parametrat e qarkut</i>	Tekst/Diagramin
Ndërprerësit	Tekst/Diagramin
Aranzhimi i mbrojtjes	Tekst/Diagramin
Kushtet e Vendosijes së Mbrojtjes	
Efekti Tranzient i Mbitensionit	

Planifikimi 5

Karakteristikat e **Ngarkesës**

Për **Gjeneratorët** e Pavarur dhe **Konsumatorët** e privilegjuar

Përshkrimi i të Dhënave	Njësitë
Llojet e Kërkesës:	
Kërkesa maksimale e Fuqisë Aktive	kW
Kërkesat Maksimale dhe Minimale të Fuqisë Reaktive	kVAr
Llojet e Ngarkesës dhe Aranzhimi i Kontrollës	Tekst /Diagramin
Lloji i përdorimit të starterit; Ridrejtuesit e Kontrolluar; Komanduesit e Motorëve të Mëdhenj;	
Ngarkesa maksimale fazore kur ngarkesa është	Amp/Fazë

maksimale	
Jobalansimi maksimal i fazës	Amp/Fazë
Përbërja maksimale e harmonikut	% e numrit të harmonikut
Ngarkesa fluktuitive:	
Vlera e ndryshimit të fuqisë aktive dhe reaktive me rritje dhe rënje	kW/Sec kVAr/Sec
Intervali më i shkurtër i përsëritjes në mes të fuqisë aktive dhe reaktive	Sec
Hapi më i madh i ndryshimit në fuqinë aktive dhe reaktive në rritje dhe në rënie	kW kVAr
Ngarkesa e Çrregullimit	Tekst

Fundi i Dokumentit